



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Raporti Vjetor 2021



Rrjeti i Grave të Kosovës

Raporti Vjetor 2021



© Rrjeti i Grave të Kosovës, dhjetor 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar burimin.

Ky raport është përgatitur nga anëtarët e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga Bashkimi Evropian (BE), Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), UN Women, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), Sweden Sverige, dhe Sigrid Rausing Trust si përgjegjësi e RrGK-së për të raportuar tek organizatat anëtare të saj. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartpërmendur.

www.womensnetwork.org



Përmbajtja

Hyrje	8
Vizioni ynë	8
Misioni ynë	8
Strategjia jonë	8
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së	9
Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë	10
Krijimi dhe zbatimi i një strategjie për përparimin e lëvizjes feministe	10
Rritja e solidaritetit ndërmjet organizatave të grave	11
Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre	14
<i>Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave</i>	28
Gratë në Politikë dhe Vendimarrje	32
Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%)	36
Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OSHCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE	47
Përmirësimi i integritetit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre	55

Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II	58
Përmirësimi i projektimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II	61
Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor	63
Jeta pa dhunë me bazë gjinore.....	64
Përmirësimi i vetëdijesimit dhe vëmendjes në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve, në trajtimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual .	72
Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual	75
Përmirësimi i mbështetjes institucionale dhe publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.....	76
Fuqizimi Ekonomik i Grave	78
Rritet përqindja e grave që kanë qasje në trashëgimi dhe pronë	83
Përmirësimi i perspektivës gjinore në reformat që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE	84
Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.....	86
Rritja e numrit të qendrave të kujdesit për fëmijë në proporcion me numrin e fëmijëve në nevojë	86
Përmirësimi i kurrikulës dhe teksteve shkollore nga perspektiva gjinore.....	87
Vlerësimi i punës së RrGK-së	88

Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2021	90
.....	103
.....	104
Rreth nesh	105
Bordi i Drejtorëve të RrGK-së	105
Bordi Këshillëdhënës i RrGK-së	105
Stafi i RrGK-së në vitin 2021	105
Organizatat anëtare të RrGK-së	108
Shtojca 1. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës për Anëtarët e RrGK-së	127
Shtojca 2. Të arriturat e Avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2021	142

Hyrje

Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka vizion një Kosovë në të cilën gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe jetë pa dhunë.

Misioni ynë

Misioni i Rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, fetare, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual, dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve e rrjetëzimeve, si dhe përmes hulumtimeve, avokimit e shërbimeve.

Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e tij, RrGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2019-2022 (të cilën mund ta gjeni në [faqen e internetit të RrGK-së](#)). Qëllimi i kësaj strategjie është ta drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2018 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, Bordi i Drejtorëve, partnerët, dhe palët e tjera relevante. Kjo strategji e RrGK-së është e ndarë në gjashtë fusha programore: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe



vendimmarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore, V) Fuqizimi ekonomik i grave, si dhe VI) Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit Rrjeti raporton te organizatat anëtare, partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport është i ndarë gjashtë pjesë bazuar në gjashtë programet e lartcekura të RrGK-së dhe qëllimet afatgjata të tyre:

- Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
- Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
- Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
- Fuqizimi ekonomik i grave;
- Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2021 deri me 30 nëntor, lidhur me secilin nga këto programe. Pjesët e mëposhtme përmbajnë informata lidhur me përparimin e arritur drejt çdo objektiv dhe rezultati të pritur si dhe informata rreth buxhetit, mbështetësve, bordit të drejtorëve dhe atij këshillëdhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve si dhe përfituesve të granteve.

Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë

Qëllimi kryesor i këtij objekti është që të fuqizohet lëvizja feministe në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Siç tregohet edhe nga treguesit e mëposhtëm, RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij objekti:

- RrGK ka zbatuar përafërsisht 68.5% të Strategjisë;
- Gratë dhe burrat kanë ndërmarrë dhjetë nisma në 2021, kurse 49 gjithsej që nga viti 2015 për të mbështetur lëvizjen e grave, duke dëshmuar kështu që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitet që të vazhdojnë këtë punë; dhe
- Anëtarët e RrGK-së dhe Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë kanë vazhduar të jenë tejet aktive dhe të zëshme.

Për realizimin e këtij qëllimi afatgjatë, është bërë përparim drejt objektivave të renditura më poshtë, të cilat janë të detajuara në tituj.

Krijimi dhe zbatimi i një strategjie për përparimin e lëvizjes feministe

Këtë vit, nga 12-14 nëntor, RrGK organizoi punëtori për planifikimin e strategjisë feministe, në Durrës, Shqipëri. Duke i respektuar masat mbrojtëse kundër COVID-19, me shumë se 100 organizata anëtare të RrGK punuan së bashku për hartimin e strategjisë feministe. Kjo strategji do të finalizohet së shpejti



dhe do t'u jepet anëtareve për shqyrtim dhe miratim përfundimtar si pjesë e strategjisë së ardhshme organizative të RrGK-së.

Rritja e solidaritetit ndërmjet organizatave të grave

Përvoja e RrGK-së sugjeron se mbështetja dhe ruajtja e solidaritet ndërmjet organizatave të grave janë jetike në krijimin e një lëvizjeje feministe të qëndrueshme. Në këtë drejtim, RrGK ka shënuar përparim drejt arritjes së objektivave të vitit 2021. RrGK ka vazhduar partneritetin me organizatat për të drejtat e grave në rajon përmes pjesëmarrjes së saj në pesë koalicione rajonale ndëretnike. Kjo dëshmohet nga 69 partneritete, koalicione dhe nisma të përbashkëta të ndërmarra që nga viti 2015. Rezultatet e këtij viti janë të renditura më poshtë.



Anëtarët e RrGK-së të informuara për nismat e anëtareve të tjera, aktivitetet e RrGK-së, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

RrGK ka vazhduar të informojë anëtarët e saj për nismat, aktivitetet e RrGK-së dhe mundësitë për përfitim të fondeve. RrGK mbajti pesë takime të anëtareve, ku 140 anëtare, partnerë dhe mbështetës të ndryshëm shkëmbyen informata dhe u njoftuan për aktivitetet e vazhdueshme të RrGK-së dhe organizatave të tjera anëtare. Që nga viti 2015, gjithsej 1,335 gra dhe burra kanë marrë pjesë në takimet e RrGK-së. Gjatë këtyre takimeve, anëtarët e RrGK-së luajtën një rol të rëndësishëm në zbatimin e përbashkët të strategjisë, diskutimin e zhvillimeve socio-politike në Kosovë, si dhe në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.



Anëtarët e RrGK-së bashkëpunojnë në hartimin e strategjisë feministe, Durrës, tetor 2021



Më shumë aktivistë dhe aktiviste të përfshirë në lëvizjen feministe

Gjatë vitit 2021, RrGK ka angazhuar mbi 115 vajza dhe djem përmes punës vullnetare, Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë dhe aktiviteteve të tjera. Kjo u ka dhënë atyre mundësi që të përfitojnë më shumë aftësi rreth organizimit, hulumtimit, avokimit, integritit të çështjeve gjinore në avokimet për të drejtat e njeriut, monitorimin e seancave gjyqësore, dhunës me bazë gjinore, si dhe çështjeve të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Angazhimi i më shumë të rinjve në këto përpjekje mund të ndihmojë në fuqizimin e lëvizjes feministe në Kosovë.

Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile

Në vitin 2021, RrGK dhe anëtarët e saj kanë qenë të përfshira në pesë nisma ndëretnike. Rrjeti u ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik organizatave që kanë përfituar grante përmes Fondit të Grave të Kosovës në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (BP). Në këtë bashkëpunim morën pjesë edhe përfituesit e këtyre organizatave si dhe Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë (Lobi). RrGK ka vazhduar partneritetet e saj ndëretnike në rajon përmes Koalicionit për Adresimin e Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë në BP; partneritete me organizata që synojnë integritimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE); me Rrjetin Mbikëqyrës të Buxhetimit Gjinor (RrMBGj), nismë e përbashkët e organizatave partnere në Ballkanin Perëndimor dhe në Republikën e Moldavisë, që kërkon të institucionalizojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; dhe një rrjet organizatash që hulumtojnë fondet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave; dhe Rrjeti Kundër Dhunës me Bazë Gjinore në Ballkanin

Perëndimor, duke përfshirë këtu organizata të shoqërisë civile nga pesë shtetet për përmirësimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. RrGK është bërë anëtare e Shoqatës për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), një organizatë ndërkombëtare feministe e përkushtuar për arritjen e barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në vitin 2021, RrGK po ashtu u bë anëtare e Lobit Evropian të Grave. Gjithashtu, RrGK ishte pjesë e Komitetit për të Drejtat e Njeriut, një grup ky i organizatave të shoqërisë civile i cili çdo vit mbikëqyrë dhe raporton për të drejtat e njeriut në Kosovë nga perspektiva e shoqërisë civile.

Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë të gjallë atë. RrGK ka mbështetur anëtarët e veta dhe organizatat e tjera në rajon në avancimin e kapaciteteve të tyre organizative dhe të avokimit, përmes mentorimit personal dhe Fondit të Grave të Kosovës.

Rrjeti ka vazhduar Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese për të vlerësuar kapacitetet e organizatave anëtare, partnerëve dhe OSHC-ve nga rajoni që përfitojnë grante. Gjatë vitit 2021, RrGK ka bashkëpunuar me 50 organizata në Kosovë dhe rajonin e BP-së për të krijuar Plane për Zhvillimin e Kapaciteteve, të përshtatshme për çdo organizatë. RrGK pastaj i ka mbështetur këto organizata në zbatimin e planeve të tyre. Si rezultat, më shumë se 27 organizata kanë përmirësuar kapacitetet e tyre organizative dhe avokuese.



Puna e RrGK-së dhe anëtareve të saj më e dukshme për partnerët e mundshëm, aktivistet ndërkombëtare dhe mbështetësit e mundshëm

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGK-së, në faqen në Facebook, Twitter, Instagram, dhe në buletin elektronik mujor “Zëri i Grave Kosovare”. RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 18,018 në 2018 në 24,615 në 2021. Kurse, në Twitter dhe Instagram, numri i ndjekësve është rritur nga 780 në 1,432, respektivisht nga 1,279 në 2,860. Gjithashtu, 840 persona e pranojnë përmes emailit buletin “Zëri i Grave Kosovare”. Gjatë vitit 2021, RrGK ka pasur 413 paraqitje në media dhe ka dërguar 36 kumtesa për media, duke përfshirë:

1. GSBGj i bën thirrje KQZ-së t’i përmbahet Ligjit për Barazi Gjimore
2. RrGK u bën thirrje partive politike të përmbahen nga gjuha kërcënuese dhe ofenduese
3. RrGK përkrah protestën në Prizren: Drejtësi për secilën grua të vvarë!
4. RrGK bën thirrje: Votoni për më shumë gra në parlament
5. RrGK përgëzon KQZ-në për mbarëvajtjen e zgjedhjeve
6. RrGK: Zgjedhjet dëshmuar forcën e grave, përpjekja për barazi vazhdon
7. RrGK, ADA, dhe Sida nënshkruajnë kontratë për avancimin e të drejtave të grave në Kosovë
8. RrGK: Shteti të parandalojë vrasjet e grave
9. RrGK kërkon nga Qeveria në ardhje zbatimin e Ligjit për Barazi Gjimore në emërimin e kabinetit
10. RrGK lanson raportin “Një ulëse në tryezë”
11. RrGK: Gratë po vriten e po dhunohen, drejtësia po mbyll sytë



12. RrGK lanson raportin “Nga Ligjet në Vepra”
13. RrGK kërkon përfshirjen e grave dhe nevojave të tyre në dialogun me Serbinë
14. RrGK në përkrahje të protestës për rastin e ngacmimit seksual ndaj të miturës
15. RrGK mirëpret dënimin e Pajazitajt, kërkon që dhuna ndaj grave të luftohet pa kompromis
16. RrGK kundërshton shkarkimin e Kryetares së KQZ-së
17. RrGK dënon gjuhën seksiste të Shalës
18. RrGK u dërgon letër të hapur partive politike: Kërkohet përfshirje e barabartë e grave në zgjedhjet lokale
19. RrGK inkurajon Policinë e Kosovës për hetimin e lokaleve ku dyshohet se po ndodh prostitucion i detyrueshëm
20. RrGK, pjesë e organizatave të rajonit që krijuan protokolin për Këshillim Online për gratë që përjetojnë dhunë
21. RrGK: Dhuna ndaj vajzave po përsëritet, institucionet po heshtin
22. Barazia Gjinore është obligim ligjor në zgjedhjet lokale
23. RrGK me rekomandime për buxhetin e komunave për vitin 2022: Të zbatohet buxheti i përgjegjshëm gjinor
24. RrGK kërkon dënimin maksimal të fajtorëve për vrasjen e 18-vjeçares
25. Fondi i Grave të Kosovës ndan 109,312€ për 23 organizata të grave në Kosovë
26. Fondi i Grave të Kosovës ndau edhe 49,673€ për 11 organizata të grave në Kosovë



27. RrGK kundër uljes së dënimit për Nuhi Mavrovqanin, u bën thirrje institucioneve të drejtësisë që të mos heshtin
28. RrGK fillon fushatën “Voto për më shumë gra në zgjedhje lokale”
29. RrGK kërkon që dhunimi i 12-vjeçares në Kamenicë të trajtohet me urgjencë nga institucionet e drejtësisë
30. Institucionet e drejtësisë vazhdojnë të inkurajojnë dhunuesit e vajzave
31. RrGK bën thirrje: Votoni për më shumë gra në zgjedhje lokale
32. RrGK dhe UN Women dërgojnë rekomandimet për buxhetin e vitit 2022: Kërkohej përfshirja e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor
33. Fondi i Grave të Kosovës mbështetë tetë organizata me rreth 80,000€
34. RrGK: Nuk ka drejtësi për gratë kur nuk ka denime për vrasësit
35. RrGK fillon fushatën vetëdijësuese për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me politikat e përgjegjshme gjinore për familjen
36. Mes miqsh, RrGK mbajti Kuvendin e 19 Vjetor të Anëtareve

Më shumë anëtare kërkojnë fonde, planifikojnë në mënyrë efektive, udhëheqin organizata dhe ndërmarrin nisma efektive avokuese

Grantet e Fondit të Grave të Kosovës për anëtarët e RrGK-së

Në 2021, përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK), RrGK ka ndarë 34 grante për 34 organizata në Kosovë në shumën e 158,995 eurove. Këto grante janë përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë (90,733€), Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) bashkë financiar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë (49,673€), si dhe Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA) (18,579€).

Po ashtu, përgjatë vitit 2021 FGK për herë të parë ka ofruar mbështetje organizative për tetë organizata anëtare të RrGK-së të përkushtuara për avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Kosovë financiar nga Trusti Sigrid Rausing (79,740€).



RrGK mbajti Sesion Orientues me 34 përfitues të raundit të 15-të të FGK-së, shtator 2021



Iniciativat e mbështetura nga RrGK në 2021 përfshijnë:

1. Partners Kosova me iniciativën: “Gratë e bëjnë ndryshimin” (5,000€ financuar nga BE)
2. Down Syndrome Kosova me iniciativën: “Përfshirja e personave me nevoja të veçanta në proceset vendimmarrëse” (5,000€ financuar nga BE)
3. OJQ Me dorë në Zemër me iniciativën: “Fuqizimi i rolit të gruas në proceset publike, garanci për qeverisje të mirë” (4,967€ financuar nga BE)
4. Nas Dom me iniciativën: “Feminizmi për fillestarët” (4,998€ financuar nga BE)
5. Asosacioni i Grave Aureola me nismën: “Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje” (4,999€ financuar nga BE)
6. Art Without Limits me iniciativën: “Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara përmes artit” (4,984€ financuar nga BE)
7. Asosacioni i të Rinjëve për të drejtat e njeriut me iniciativën: “Arritja e barazisë gjinore në proceset vendimmarrëse” (4,923€ financuar nga BE)
8. In Time me iniciativën: “Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse drejt fuqizimit ekonomik të grave” (4,866€ financuar nga BE)
9. Centar Manjske Zajednice me iniciativën: “Kam të drejtë të informohem!” (5,000€ financuar nga BE)

10. Moravski Biser me iniciativën: “Përfshirja e grave nga zonat rurale në jetën publike dhe politike” (4,767€ financuar nga BE)
11. Glas Zena Partes me iniciativën: “Përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse në nivel lokal në komunën e Parteshit” (3,640€ financuar nga BE)
12. Shoqata e Mamive të Kosovës (SHMAKS) me iniciativën: “Përmirësimi i kujdesit për shëndetin riprodhues të grave dhe vajzave” (4,987€ financuar nga BE)
13. Shqiponjat e Dardanës me iniciativën: “Përkrahja e grave kandidatë për asamble komunale dhe ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave rurale për rolin e votës së tyre” (4,895€ financuar nga BE)
14. Vizionida me iniciativën: “Promovimi i grave në politikë dhe vendimmarrje në komunën e Shtimes” (3,795€ financuar nga BE)
15. Jeto Vepro dhe Krijo me iniciativën: “Promovimi dhe mbështetja e grave dhe vajzave për të marrë pjesë në procese vendimmarrëse” (4,993€ financuar nga BE)
16. Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës (IPVK) me iniciativën: “Qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbime publike” (4,992€ financuar nga BE)
17. Okarina e Runikut me iniciativën: “Fuqizimi i gruas në politikë dhe vendimmarrje” (4,951€ financuar nga BE)
18. Era Fruit me iniciativën: “Fuqizimi përmes përfaqësimit më të madh të grave në politikë në nivel lokal” (4,997€ financuar nga BE)



19. Svet Anjela me iniciativën: “Rritja e pjesëmarrjes së grave në procesion zgjedhor”(3,975€ financuar nga BE)
20. Gruaja Hyjnore me iniciativën: “Edukata seksuale si lëndë mësimore në shkolla fillore dhe të mesme” (4,974€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
21. Humanus Vita me iniciativën: “Vetëdijësimi i të rinjve për ngacmimet dhe sulmet seksuale si dhe rëndësinë e raportimit të hershëm” (4,754€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
22. Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) me iniciativën: “Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë” (4,006€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
23. Handikos Mitrovica me iniciativën: “Shëndeti riproduktiv dhe edukimi seksual i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Komunën e Mitrovicës” (4,432€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
24. Shoqata e Grave Jeta me iniciativën: “Fuqizimi i grave dhe të rinjve për parandalimin e dhunës në baza gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit” (4,846€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
25. Shoqata e Grave Ura Sociale me iniciativën: “Ngritja e vetëdijes për parandalimin e ngacmimeve seksuale” (4,317€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
26. Instituti i Psikologjisë Aplikative me iniciativën: “Mbështetja e vajzave adoleshente për t’i tejkaluar problemet sociale dhe emocionale” (4,188€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)

27. Shoqata e Juristeve NORMA me iniciativën: “Mëso dhe vepro për një shoqëri pa dhunë me bazë gjinore” (4,970€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
28. Qendra e Gruas ATO me iniciativën: “Edukimi rreth shëndetit riprodiktiv” (4,552€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
29. Gruaja Fermere me iniciativën: “Edukimi seksual i përshtatur sipas moshës dhe zhvillimit” (3,705€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
30. Zensko Pravo me iniciativën: “Parandalimi i dhunës ndaj grave në Veri të Kosovës” (4,927€ financuar nga ADA, bashkëfinancuar nga Sida)
31. Business Women Mitrovica me iniciativën: “Promovimi i punësimit për përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale në Komunën e Mitrovicës” (4,537€ financuar nga UNFPA)
32. OJQ Drugëza me iniciativën: “Fuqizimi i gruas në biznes, formë e mirë e promovimit të barazisë gjinore” (4,530€ financuar nga UNFPA)
33. Organizata për reforma lokale - EULOC me iniciativën: “Fuqizimi i grave për avokim për punësim dhe subvencione në Komunën e Vitisë” (4,512€ financuar nga UNFPA)
34. Qendra rinore Lipjan me iniciativën: “Të fuqizohen gratë përmes ekonomisë lokale” (4,999€ financuar nga UNFPA)
35. Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës – Mbështetje Organizative (10,000€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
36. In Time – Mbështetje Organizative (10,000€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)



37. Shoqata e Jurisëve NORMA – Mbështetje Organizative (9,998.00€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
38. Moravski Biser – Mbështetje Organizative (9,762€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
39. OJQ Drugëza – Mbështetje Organizative (9,993.00€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
40. OJQ Gruaja Hyjnore – Mbështetje Organizative (9,998€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
41. OJQ Me dorë në Zemër – Mbështetje Organizative (9,999.00€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)
42. Women's Alliance for Integration – Mbështetje Organizative (9,990.00€ financuar nga Trusti Sigrid Rausing)

Që nga vjeshta e vitit 2012, përfituesit e FGK ndërmorën së paku 515 nisma avokuese me mbështetjen e FGK-së, dhe gjithsej 24,387 persona kanë përfituar nga iniciativat e anëtareve të RrGK. Në vitin 2021, anëtarët e stafit të RrGK ofruan rreth 2552 seanca mentorimi përmes e-mailit, telefonit dhe disa takimeve individuale për përfituesit e granteve të FGK-së. Komisioni i Shqyrtimit të Granteve gjithashtu kontribuoi në rritjen e kapaciteteve të anëtareve duke shqyrtuar çdo aplikim dhe duke ofruar këshilla praktike për aplikime në të ardhmen. Kjo do t'i ndihmojë anëtarët e RrGK të përgatisin aplikime më të mira për FGK dhe donatorë të tjerë në të ardhmen. Shtojca I. përmban një listë të të gjitha granteve të dhëna nga FGK për anëtarët e RrGK në vitin 2021 dhe rezultatet e pritshme nga to.

Fondi i Grave të Kosovës Zgjeron Dhënien e Granteve në BP

Në vitin 2020 RrGK dhe partnerët e saj në Koalicionin e Organizatave për të Drejtat e Grave kundër Diskriminimit në BP kanë dhënë 14 grante për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në rajon përmes FGK. Nga këto, gjashtë grante (një për secilin vend të BP) kanë mbështetur OShC-të të përqendruara në sigurimin e ndihmës juridike dhe monitorimin e gjykatave. Dy grante (një në Serbi dhe një në Shqipëri) kanë financuar avokimin e OShC-ve për ndryshime ligjore dhe politike dhe/ose përgjigje të përmirësuar institucionale. Gjashtë grante (një për secilin vend të BP) u janë ndarë OShC-ve të përqendruara në zhvillimin e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të grave për të raportuar diskriminimin. Në total, grantet, në vlerë prej 215,319€, janë pjesë e nismës të përbashkët, “Përparimi i të Drejtave të Punës së Grave”, financuar nga BE dhe bashkë-financuar nga Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. OShC-të e mëposhtme zbatuan sukseshëm nismat e tyre gjatë vitit 2021, përfshirë përshtatjen e nismave të tyre për t’i adresuar çështjet lidhur me pandeminë Covid-19.

Shqipëri

- Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare në Tiranë: “Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë përmes Përmirësimit të Qasjes në Drejtësi”,
- Qendra e Zhvillimit të Komunitetit Sot për të Ardhmen: “Avokimi për përmirësimin e reagimit institucional ndaj diskriminimit gjinor në punë duke ndarë praktikat në Bashkinë e Lezhës dhe krijimi i ndërveprimeve me komitetin për mbrojtjen nga diskriminimi në punë”, dhe



- Linja e këshillimit për vajzat dhe gratë: “Fuqizimi i grave dhe vajzave për të raportuar diskriminimin në bazë gjinore”.

Bosnjë dhe Hercegovinë

- Fondacioni i Rrjetit të Grave të Bashkuara: “Përmirësimi i pozitës së grave në punësim dhe parandalimi i diskriminimit me bazë gjinore në Bosnjë dhe Hercegovinë”, dhe
- Akademia e Fondacionit për Gratë: “Edhe ky është diskriminim”.

Kosovë

- Instituti i Kosovës për Drejtësi: “Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë”, dhe
- Qendra e Kosovës për Studime Gjinore: “Parandalimi i të gjitha formave të diskriminimit në vendin e punës”.

Maqedoni e Veriut

- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut: “Gratë punëtore bashkohen”, dhe
- Shoqata Punëtoret e Zëshme të Tekstilit: “Promovimi i të Drejtave të Punëtoreve të Tekstilit”.



Mal i Zi

- Sindikata e Mediave të Malit të Zi: “Barazia përmes Drejtësisë: Rastet e Diskriminimit në Punë”, dhe
- Shoqata e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara: “Të fuqizuar, të punësuar, të përfshirë”.

Serbi

- Shoqata e Viktimologjisë së Serbisë: “Njihni Diskriminimin Gjinnor, Identifikoni Shkeljet e Ligjit të Punës dhe Punësimit! Reagoni!”,
- Iniciativa A I I - për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale: “Përmirësimi i Praktikave Institucionale në Parandalimin e Diskriminimit ndaj Grave në Tregun e Punës në Serbi”, dhe
- Shoqata ROZA për të Drejtat e Punës së Grave: “Çfarë më pret në tregun e punës”.



Ngriten kapacitetet e stafit të RrGK

RrGK ka vazhduar që të ofrojë mundësi për ngritje të kapaciteteve për stafin, duke përfshirë ato që ndërlidhen me komunikim ndërmjet zyrave, integrimin e perspektivës gjinore, sigurinë digjitale dhe financat. Monitorim i punës u ofrua në çështjet e lidhura me avokimin te Bashkimi Evropian (BE); kryerjen e analizave gjinore, shkrimin e koncept-dokumenteve; hartimin e strategjive avokuese; hartimin e raporteve; monitorimin dhe vlerësimin; hulumtimin si dhe aftësitë e të shprehurit në publik. Më tej, RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave Avokate (EWLA) organizoi dy punëtori për anëtarët e stafit, njëra me temën: "Mjetet juridike të BE-së dhe organet e së drejtës ndërkombëtare" kurse tjetra mbi "Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë nga perspektiva gjinore".



RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave Avokate (EWLA) mbajti punëtorinë e tretë, qershor 2021

Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave

Sado që disa iniciativa avokuese mund të ndërmerren në baza vullnetare, organizatat për të drejtat e grave (OSHCG-të) ende kanë nevojë për burime për të përkrahur shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon mbështetje, andaj RrGK vazhdoi përpjekjet në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe në rajon. Në vitin 2021, RrGK takoi disa financues si dhe dërgoi përmbledhje të politikave për t'i vetëdijesuar ata lidhur me nevojat financiare të OSHCG-ve. Pas avokimit, RrGK kontribuoi në sigurimin e burimeve shtesë për OSHCG-të në Kosovë dhe rajon, siç dëshmohej nga rritja substanciale e fondeve të dhëna nga Fondi i Grave të Kosovës këtë vit.

Përmirësimi i zbatimit të Strategjisë së RrGK-së për Ngritje të Fondeve

RrGK ka finalizuar Strategjinë e Filantropisë, e cila identifikon mënyra të reja dhe alternative të mbledhjes së fondeve, përveç fondeve ndërkombëtare, të cilat mund të mbështesin RrGK-në dhe anëtarët e saj në planin afatgjatë. RrGK ka hulumtuar mundësi të ndryshme filantropie që ekzistojnë në të gjithë botën, veçanërisht në kontekste të ngjashme si Kosova. Rrjeti gjithashtu ka parë edhe ato mënyra që janë përdorur në Kosovë për të



Materialet promovuese të RrGK-së me mesazhe feminist në dispozicion për donacion



pasuruar Strategjinë e Filantropisë. RrGK ka filluar përpjekjet për zbatimin e kësaj Strategjie. Kjo përfshinë edhe prezantimin e materialeve promovuese të RrGK-së të cilat përmbajnë mesazhe feministe, të qasshme në person ose online. Donacionet e pranuar për këta artikuj kontribuojnë në Fondin e Qëndrueshëm të RrGK-së, i cili ndihmon në mbulimin e shpenzimeve thelbësore dhe në mbështetjen e programeve të rëndësishme për barazinë gjinore. Sa u përket rezultateve, RrGK ka rritur kursimet në Fondin e saj të Qëndrueshmërisë nga 3,263 € në vitin 2018 në 33,448 € në vitin 2021.

Përmirësimi i njohurive dhe mirëkuptimit midis organeve përkatëse të BE-së dhe donatorëve të tjerë në lidhje me llojet e mbështetjes që u nevojiten OShCG-ve të ndryshme

Në vitin 2020 RrGK ka publikuar hulumtimin tejet të rëndësishëm, *Ku janë paratë për të drejtat e grave?*, i cili shqyrton trendet e financimit në BP në mbështetje të OShCG-ve. Punuar në bashkëpunim të ngushtë me OShCG-të partnere në rajon dhe mbështetur nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, raporti hulumtues u lansua në BE në Bruksel, në Sida në Suedi dhe në të gjashtë vendet e BP. Në 2021, RrGK, së bashku me Fondacionin Kvinna till Kvinna dhe OShCG partnere në BP, organizuan disa takime shtesë me financues drejt realizimit të rekomandimeve për nevojat e fondeve të OShCG-ve. Së bashku me Qendrën Autonome të Grave dhe partnerët në rrjetin kundër dhunës me bazë gjinore në Ballkanin Perëndimor, RrGK ka përgatitur një përmbledhje të këtij hulumtimi që të publikohet nga Lobi Evropian i Grave. RrGK shfrytëzoi platformën e KB Forumit për Barazi të Gjeneratave (FBGj) për të avokuar për më shumë fonde të ndryshme për OShCG-të dhe Lëvizjen Feministe. RrGK po ashtu ka shkruar një letër

të nënshkruar nga 145 OShCG që i'u dërgua Koalicionit për Aksion në GEF. Në mesin e shumë çështjeve, letra avokoi rreth nevojës për të krijuar modalitete të ndryshme të financimit, veçanërisht financimin shumëvjeçar dhe Mbështetjen Organizative. Letra thekson dobietë nga financimet e tilla, që mund të kontribuojnë drejt aksioneve strategjike dhe afatgjate, fleksibilitetit në kohë të paqëndrueshmërive dhe konflikteve politike, e gjithashtu mund të kontribuojë edhe drejt zgjerimit të kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OShCG-ve dhe lëvizjeve.

Përveç kësaj, RrGK shkroi një përmbledhje të pikëpamjeve të IPA III: Mundësitë e Humbura dhe të Mbetura për Avancimin e Barazisë Gjinore me rekomandime që përfshijnë përmirësimin e mbështetjes ndaj OShCG-ve. RrGK u dërgoi këtë përmbledhje disa akterëve në Komisionin Evropian dhe në BE duke përfshirë Zyrën e BE-së në Kosovë. RrGK gjithashtu avokoi për këto rekomandime gjatë takimeve avokuese me zyrtarë të ndryshëm të BE-së.

Gjatë Javës së Avokimit të BE-së të organizuar nga Kvinna till Kvinna, RrGK zgjeroi dhe përmirësoi njohuritë dhe të kuptuarit e organeve përkatëse të BE-së në lidhje me format e ndryshme të mbështetjes që kanë nevojë OshCG-të. Gjatë takimeve të ndryshme me zyrtarë të BE-së të përfshirë në procesin e bërjes së politikave për Financimin e Jashtëm të BE-së, RrGK ngriti nevojën për të rritur fondet e ndara për OShCG-të, dhe nevojën për financim të qëndrueshëm për Lëvizjen Feministe. Një takim informues me çështjet e lartcekura u zhvillua me Michela Matuella, Ushtruese e Detyrës së Drejtores për Ballkanin Perëndimor, DG NEAR dhe me Charlotte Lisalotte, Këshilltare për çështje Gjinore, Shërbimi Evropian i Veprimt të Jashtëm.



RrGK gjithashtu nënshkroi një letër avokimi të Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, e cila bënte thirrje që Struktura e Shoqërisë Civile e BE-së të mbështesë drejtpërdrejt organizatat lokale. Për më tepër, RrGK së bashku me partnerët në rajon është afër përfundimit të dy analizave të politikave me rekomandime për nevojën për financim nga Struktura e Shoqërisë Civile të BE-së për adresim të dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.

Ekspertët e RrGK-së kanë vazhduar të mbështesin Zyrën e BE-së në Kosovë, Agjencinë Austriake për Zhvillim, Caritas Kosova dhe kontraktorët e tjerë fitimprurës dhe jofitimprurës që zbatojnë programet e zhvillimit në Kosovë, duke rekomanduar mundësi bashkëpunimi me (dhe mbështetje për) OShCG-të e cila do të kontribuonte në efektivitetin dhe qëllimet e tyre për zhvillim. Në disa raste, kjo përkthehet në kontraktorë që angazhojnë OShCG-të si partnerë dhe mbështesin punën e tyre.

Ndërgjegjësimi i përmirësuar institucional dhe publik mbi rëndësinë e zbritjes tatimore për të mbështetur punën e grupeve për të drejtat e grave

Raporti i lartpërmendur, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, përfshin rekomandime për përmirësimin e sistemit të tanishëm tatimor, ashtu që të përmirësohet mjedisi për individët dhe bizneset që të bëjnë donacione në mbështetje të shoqërisë civile, duke përfshirë këtu grupet e të drejtave të grave.

Gjatë integritetit të perspektivës gjinore në politikat publike, RrGK dërgoi rekomandime për përmirësimin e sistemit tatimor, siç ishte rasti me Programin e Reformës Ekonomike dhe në lidhje me takimin e nënkomitetit për çështjet ekonomike, financiare dhe statistika të Marrëveshjes së Stabilizim Associmit (MSA).



Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është pjesëmarrja aktive e grave në politikë dhe vendimmarrje, në nivelin lokal dhe atë qendror. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij qëllimi. Për shembull, avokimi i RrGK, ndër të tjera, kontribuoi në zgjedhjen e më shumë grave në pozita vendimmarrëse. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2021, një grua kandidate ka marrë më së shumti vota se çdo kandidat në histori të Kosovës, si dhe mbi 60% e grave kanë marrë pjesë në zgjedhje. Më tej, 43 gra u zgjodhën deputete, katër më shumë se në vitin 2019, një rritje nga 32,5% në 35,8% në zgjedhjet e fundit. Vetëm nëntë gra u zgjodhën me kuotë gjinore, kurse 34 gra fituan mandatin me votën popullore. Qeveria e tanishme e Kosovës ka emëruar dy gra si zëvendëskryeministre dhe nga 15 ministri, pesë drejtohen nga gra (një rritje nga 18.8% në zgjedhjet e fundit në 33.3% në 2021). Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, dy gra serbe u zgjodhën kryetare të komunave dhe 364 gra u zgjodhën këshilltare komunale. Tutje, dy gra nga komuniteti ashkali dhe ai egjiptian, si dhe një grua me aftësi të kufizuara janë zgjedhur këshilltare komunale duke shënuar përmirësim në përfaqësimin e tyre krahasuar me vitet e mëparshme.

Një indikator tjetër i pjesëmarrjes së përmirësuar të grave në politikë dhe vendimmarrje në vitin 2021 ishin 7 politikat e ndryshuara për të paraqitur më mirë prioritetet e grave, integrimin e perspektivës gjinore ose përputhshmërinë me Ligjin për Barazi Gjinore. Që kur RrGK filloi që ti gurmtojë këto informata, Rrjeti, anëtarët e saj si dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë arritur që suksesshëm të avokojnë për ndryshimin e 162 politikave për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave, në nivel lokal dhe qendror.



Në aspektin e rritjes së perspektivës gjinore në politikëbërje, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe të burrave, janë publikuar gjithsej tetë politika, në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së, duke përfshirë rekomandimet e RrGK-së. RrGK monitoron hartimin e politikave në nivel nacional, duke ofruar të dhëna përmes dëgjimeve publike dhe platformës së konsultimit publik.

Duke ditur se se barazia gjinore është vlerë themelore e BE-së, RrGK po ashtu monitoron edhe procesin e anëtarësimit në BE, duke ofruar perspektivë gjinore edhe në nivel të BE-së. Kësisoj, Kosova duhet të inkorporojë perspektivën gjinore në dialogun politik të BE-së dhe investimet sipas Planit III të Veprimit Gjinor të BE-së. Më poshtë janë të listuara dokumentet që janë publikuar në vitin 2021 e të cilat përfshijnë kontributin e RrGK-së:

1. Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023
2. Plani i Veprimit ERA II
3. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2021
4. Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit 2021-2025
5. Plani i Veprimit Gjinor i BE-së III
6. Plani i Zbatimit të GAP III në nivel vendi
7. Rregullorja (BE) 2021 / 1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III)

8. Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (2021-2025) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2023).

Sa i përket buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, është rritur në 62 numri i organizatave buxhetore që kanë dorëzuar shtojcën me të dhëna në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, sipas Qarkoreve të Buxhetit. Këtë vit, 27 nga 38 organizata buxhetore të nivelit lokal (71%) kanë dorëzuar shtojcën e tyre si pjesë e kërkesave buxhetore për vitin 2022, dhe 15 nga to (39.4%) e kanë dorëzuar atë për Kornizën e tyre Buxhetore Afatmesme. Ndërkohë, 35 nga 51 organizata buxhetore të nivelit qendror (68%) kanë dorëzuar shtojcën e tyre me buxhetore për vitin 2022. Ndonëse nuk është drejtpërdrejt rezultat i punës së RrGK, ne besojmë se RrGK dhe anëtarët e saj kanë kontribuar në këtë përmirësim në mënyrë indirekte përmes avokimit në nivel komunal dhe kombëtar, dhe është rezultat i punës së mëparshme të RrGK me Ministrinë e Financave që fillimisht prezantoi këtë kërkesë në qarkoret buxhetore.

Tutje, zyrtarët e BE-së dhe ata të qeverisë ndërmorën 10 veprime për të adresuar më mirë problemet dhe situatat e ngritura nga gratë, për integrimin e perspektivës gjinore në proces të parantaresimit në BE, si rezultat i avokimit të RrGK-së:

- I. Përmirësuan dukshëm procesin e konsultimit me OShCG, sidomos zyrtarët e BE, pasi që agjendat u ndanë paraprakisht, si dhe zyrtarët e BE-së e siguruan RrGK që rekomandimet e dhëna do të ngriten për diskutim gjatë takimeve mes strukturave të MSA-së;



2. Publikuan PRE 2021-2023, të cilin e konsultuan me RrGK-në dhe e publikuan me perspektivë të përmirësuar gjinore, duke përfshirë rekomandimet e RrGK-së;
3. Zyra e Kryeministrit publikoi Planin e Veprimit të ERA II, me rekomandimet e RrGK të përfshira në të – si dhe u zotua të përfshijë RrGK dhe OShCG në monitorimin dhe zbatimin e ERA II;
4. Zyra e BE-së në Kosovë ftoi OShCG-të për të kontribuar me rekomandime për Raportin e vitit 2021 të Komisionit Evropian për Kosovën;
5. Zyra e BE-se në Kosovë bashkë me RrGK koordinoi procesin e hartimit të Planit të Veprimit në nivel Shteti të PVGJ III, dhe organizoi takime konsultuese me organizata të shoqërisë civile për të marrë kontributet e tyre;
6. U publikua opinioni i Komitetit për Marrdhënie të Jashtme të BE për Komitetin e të drejtave të grave dhe barazi gjinore në lidhje me politikat e jashtme dhe ato të sigurisë së BE (2019/2167(INI)), duke përfshirë në të edhe komentet e rekomandimet e RrGK-së;
7. PVGJ III u publikua, me rekomandimet e RrGK-së të inkuadruara, sidomos në lidhje me prioritetet dhe vëmendjen e kërkuar ndaj çështjeve të rekomanduara;
8. U publikua rregullorja IPA III, duke integruar rekomandimet e RrGK, sidomos në lidhje me futjen e barazisë gjinore si objektive specifike;
9. Ministria e Drejtësisë ndryshoi përmbajtjen e draft-kodit Civil bazuar në rekomandimet e RrGK-së dhe organizatave të tjera bashkëpunëtoresh ashtu që ky kod të përafrohet me Acquis të BE-së për Barazi Gjinore (të njohura si *EU Gender Equality Acquis*) dhe praktikat më të mira, duke larguar

- pjesët të cilat rrezikonin të drejtat e grave për pronë dhe martesë. Pjesët të cilat e ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë dhe seksit janë ende në diskutim në grupin punues të kodit civil;
10. Zyra e BE-së në Kosovë si dhe Drejtorati i Përgjithshëm i BE për Fqinjësi dhe Negocim të Zgjerimit organizuan takim konsultativ me RrGK për hartimin e Programit për Reforma në Ekonomi, të vitit 2022, për të futur perspektivën gjinore në këtë dokument;

Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%)

Me mbështetje të BE-së, RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e me Organizatën e Personave me Distrofi Muskulare dhe Ruka Ruci posaçërisht në drejtim të rritjes së angazhimit politik në procese vendimmarrëse të afërsisht nëntë grave me aftësi të kufizuara dhe 119 grave nga komuniteti serb. Më poshtë, gjendet përshkrimi më i hollësishëm i përparimit të bërë në këtë objektivë.

Koalicioni për Barazi funksional në nivelin lokal dhe qendror Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë funksional në të gjitha komunat

Koalicioni për Barazi u krijua në 22 qershor 2018. Ai përbëhet nga gratë në politikë në nivelin qendror dhe lokal, si dhe OShC-të e drejtuara nga gratë. Koalicioni mbështetë dhe fuqizon anëtarët për të përmirësuar pozitat e grave në politikë dhe vendimmarrje dhe për të promovuar avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. Pjesëmarrëset janë zotuar se do të punojnë drejt përmbushjes së këtij misioni të



përbashkët, pa marrë parasysh preferencat e tyre politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin socio-ekonomik.

Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore në Kosovë (këtu e tutje, Lobi) është themeluar në vitin 2014. Ai bashkon gratë politike dhe gratë në shoqërinë civile për të avokuar në nivel lokal dhe qendror për avancimin drejt barazisë gjinore dhe ka vazhduar të funksionojë në 27 komuna. Numri i grave të angazhuara në Lob në vitin 2021 ishte 368. Së bashku, grupet e Lobit ndërmorën 31 iniciativa avokimi dhe kontribuan në shtatë ndryshime të politikave këtë vit. Më 24 shkurt, Lobi ka mbajtur mbledhjen e parë për të diskutuar “Gratë dhe Zgjedhjet Lokale”. Përfaqësues të institucioneve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe anëtare të RrGK e gra të angazhuara në politikë diskutuan dhe ndanë përvojat e tyre lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë në nivelin lokal. Gjatë këtij takimi u fol për arritjet, sfidat si dhe avokimet e nevojshme që duhet çuar përpara për të rritur përfaqësimin e grave në politikë dhe procese vendimmarrëse. Në pjesën e dytë të këtij

“Bashkë me RrGK-në do të përpiqemi që së bashku t'i përkrahim dhe fuqizojmë gratë në zgjedhje lokale. Sot, më shumë se asnjëherë gratë në politikë po përkrahim njëra-tjetrën dhe ne do ta shfrytëzojmë këtë moment”

Antigona Baxhaku – Idrizi, Drejtore, SHE Solutions

takimi anëtarët bënë punë në grupe, me ç'rast u identifikuan pikat kyçe mbi të cilat duhet të bazohen avokimet e ardhshme për të përmirësuar pozitën e grave në politikën lokale.



Anëtarët e Lobit dhe Koalicionit organizuan një takim të përbashkët, qershor 2021

Më 7 qershor të vitit 2021 është mbajtur mbledhja e përbashkët e anëtareve të RrGK-së, Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë si dhe Koalicionit për Barazi. Rreth 70 pjesëmarrëse diskutuan së bashku për pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet lokale, si dhe për mundësitë e avokimit dhe përkrahjes për gratë që i hynë garës zgjedhore. Në pjesën e dytë të takimit pjesëmarrëset u ndanë në grupe punuese ku diskutuan më gjerësisht rreth fushatave dhe avokimeve të nevojshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet lokale.

Më 1 dhjetor është mbajtur mbledhja e radhës e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë (Lobi). Rreth 60 pjesëmarrëse diskutuan së bashku për të drejtat e grave në Kosovë, punën e RrGK si dhe të organizatave anëtare për përmirësimin e jetës së grave e vajzave, si dhe për mundësitë e përbashkëta avokuese drejt



fuqizimit të lëvizjes feministe në Kosovë. Pjesë e rëndësishme e këtij takimi ishte Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator (BPGj) në nivel lokal, dhe roli i tij në fuqizimin socio-ekonomik të grave, si dhe prezantimi i Rrjetit Strategjik për Politika Gjimore- rrjet ky i cili është krijuar së fundi me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së mirëfilltë të grave në politikë dhe luftimin e diskriminimit të grave në skenën politike, e pjesë e së cilit është edhe RrGK-ja.

Zhvillimi i kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave

Takimi i lartpërmendur, e po ashtu edhe punëtoritë e mbajtura gjatë vitit, zhvilluan edhe më shumë kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira si dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre avokuese. Edhe këtë vit, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballë Rogova, ka vazhduar të ofrojë seanca të mentorimit për anëtarët dhe grupet e Lobit nëpër Kosovë, përmes 936 thirrjeve telefonike, e-mailit ose vizitave nëpër komuna. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokime për të drejtat e grave dhe barazinë gjimore. RrGK nuk i sheh apo trajton anëtarët e Lobit si anëtare të partive politike, por më shumë i sheh ato si udhëheqëse në komunitatet e tyre. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së gjithashtu promovoi nismat e tyre, mbështeti ato në avokim dhe i ndihmoi në tejkalimin e sfidave gjatë avokimeve të tyre drejt barazisë gjimore. RrGK informoi vazhdimisht gratë në politikë lidhur me procesin e anëtarësimit në BE dhe mundësitë e përfshirjes së tyre në këtë proces.

Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e harmonizimit të LBGJ me ligjet e tjera relevante

Më 7 qershor, përfaqësueset e RrGK-së vizituan Presidenten e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, për ta uruar atë për këtë post, si dhe për të diskutuar së bashku për mundësitë e bashkëpunimit për avancimin e mëtejshme të barazisë gjinore në Kosovë. Ndër çështjet që u diskutuan ishin: përputhja e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazi Gjinore, koordinimi i mëtejshëm për ta luftuar dhunën dhe ngacmimet seksuale ndaj grave, si dhe përfshirja e grave në dialogun Kosovë-Serbi përmes grupit të ekspertëve. Presidentja Osmani ka theksuar se përgjatë mandatit të saj, barazia gjinore është një nga prioritetet e saj së bashku me të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe me agjendën e gjelbër.

Gjithashtu, RrGK, së bashku me shumë OSHC të tjera, ka avokuar për përmirësimin e integritetit gjinor në draft- Projektligjin e Punës dhe- draft Kodit Civil. RrGK vazhdoi të shtyjë përpara nevojën për



Përfaqësueset e RrGK-së kanë vizituar Presidenten e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, qershor 2021



hartimin e dispozitave të pushimit të lehonisë, atësisë dhe atij prindëror të Ligjit të ri të Punës në harmoni me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës si dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Pikat e avokimit dhe rekomandimet lidhur me këtë çështje iu dërguan edhe komiteteve të MSA-së, siç është Nënkomiteti i MSA-së për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale.

Së bashku me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Qendrën për Barazi dhe Liri (CEL), Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Sociale (CSGD) si dhe Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR-KS), RrGK ka avokuar fuqishëm për një draft më të ndjeshëm gjinor të Kodit Civil, ku do të merret parasysh gjendja e grave në Kosovë, veçanërisht lidhur me pronën dhe martesën. RrGK së bashku me këto OShCG gjithashtu avokuan edhe për ndryshimin e neneve ekzistuese të draft-Kodit Civil që kanë të bëjnë me martesën, që ky i fundit të mos diskriminojë apo përjashtojë në baza të seksit apo gjinisë. Rekomandimet u mirëpritën nga Ministria e Drejtësisë dhe Ekipi i Projektit të Kodit Civil, ndërsa ndryshimet do të monitorohen në versionin përfundimtar të draft- Kodit Civil.

RrGK vazhdimisht ka kërkuar harmonizimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Nacionale me Ligjin për Barazi Gjinore. Gjatë takimeve me Strukturat e MSA-së, kjo çështje u theksua si një nga rekomandimet kryesore që RrGK kishte për Raportin e KE-së për Kosovën,. Po ashtu, kësaj pike iu kushtua vëmendje e veçantë gjatë javës së Avokimit të BE-së, organizuar me mbështetjen e Kvinna till Kvinna, ku RrGK shtyu përpara nevojën për harmonizimin e këtyre ligjeve, duke folur drejtpërdrejt me përfaqësues nga shtetet anëtare të BE-së, Drejtorisë së Përgjithshme të BE-së për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR), si dhe me zyrtarët për Kosovën.

RrGK ka avokuar gjithashtu për një perspektivë më të mirë të ligjeve dhe politikave të tjera, për t'i harmonizuar më mirë ato me LBGJ. Një listë e tyre mund të gjendet në pjesën e mëposhtme: *Përmirësimi i integritetit gjinor në dokumentet e lidhura me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe zbatimin e tyre.*

Komunikim dhe bashkëpunim i shtuar mes grave në politikë, organizatave të grave dhe grave votuese për çështjet që ato i konsiderojnë prioritet

Me mbështetjen e Koalicionit për Barazi, Lobi, RrGK- së dhe anëtareve të saj si dhe të grave në politikë, organizatat e drejtuara nga gratë, gratë votuese si dhe gratë në politikë arritën që të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë më shumë për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet. Për shembull, anëtarët e Lobit avokuan për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet në bashkëpunim të ngushtë me votuesit nga komunat e tyre. Këtë vit, Lobi mbajti 71 takime me gra politike, votuese dhe OJQ. Një listë e iniciativave të tyre është në Shtojcën 2.

Sa i përket dialogut Kosovë-Serbi që është ende duke vazhduar, RrGK organizoi tri diskutime online me vajzat nga komuna e Mitrovicës, Lipjanit dhe Vitisë me temën “Sfidat me të cilat përballen vajzat në aspektin e sigurisë”. Drejtorja ekzekutive, Igballë Rogova, ndau disa praktika avokuese përmes së cilave ato së bashku me organizata anëtare të RrGK-së, do të mund të adresojnë sfidat dhe problemet kyçe të identifikuara në çështjet e sigurisë. Tutje RrGK ndau edhe të gjeturat nga raporti “Një ulëse në tryezë”.



Më 14 prill, RrGK ka lansuar online raportin “[Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese](#)”. Ky raport i cili u realizua me mbështetje të UN Women, përmes Fondit të Ndërtimit të Paqes, shqyrton rolet, kontributet dhe nevojat e grave, veçanërisht vajzave, në lidhje me paqen dhe proceset e sigurisë në Kosovë që nga viti 1989. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të organizatave për të drejtat e grave në proceset e ndërtimit të paqes. Gjithashtu, ky raport përmban rekomandime për avancimin e paqes dhe të sigurisë në Kosovë, posaçërisht në kontekstin e dialogut Kosovë-Serbi. Raporti po ashtu rekomandon që të rritet përfaqësimi i grave në të gjitha pozitat e emëruara dhe të përzgjedhura të vendimmarrjes, në nivelin qendror dhe lokal, ashtu siç edhe parashihet me ligj.

Nisja e avokimeve për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

Më 6 korrik, RrGK u dërgoi një letër të hapur partive politike për t’u bërë thirrje për pjesëmarrje të barabartë të grave në zgjedhjet lokale. Përdërisa partitë ende po diskutojnë kandidaturat e mundshme për kryetarë komunash, RrGK u bëri thirrje atyre që të angazhohen për përfshirje të barabartë të grave



dhe burrave përmes: zbatimit të ligjit për barazi gjinore, ofrimit të hapësirës për përfaqësim të barabartë të grave në media dhe rritjes së mbështetjes për gratë kandidate përmes ndarjes së fondeve për fushatë.

Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së u takua me Kryetaren e Grupit të Grave Deputete, Tinka Kurti për ta uruar atë për postin e ri. Ato diskutuan për mënyrat më efikase për të vazhduar bashkëpunimin për avancimin e barazisë gjinore në Kosovë.

OSHC-të u përfshinë më shumë në çështje dhe procese të ndryshme (duke përfshirë këtu edhe dialogun politik), veçanërisht përmes takimeve të nën-komisioneve të MSA-së dhe procesit të anëtarësimit në BE, ku përmes avokimeve të ndryshme RrGK ngriti çështje që i konsideron prioritet si në nivel nacional po ashtu edhe në atë të BE-së. RrGK gjithashtu ka mbështetur dhe fuqizuar gratë për të identifikuar dhe avokuar për prioritetet e tyre. Këtë vit Lobi ndërmorën 25 iniciativa avokimi për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet.



Drejtorja ekzekutive e RrGK-së u takua me Kryetaren e Grupit të Grave Deputete, Tinka Kurti, korrik 2021

Përmirësimi i institucionalizimi të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) siguron shpërndarje dhe shpenzimin e fondeve publike në mënyrë të barabartë, efikase dhe transparente të fondeve publike. Që nga viti 2011, RrGK ka punuar dhe avokuar drejt institucionalizimit të BPGj-së në Kosovë.

Në vitin 2021, RrGK ka mentoruar gjashtë organizata gjatë zbatimit të nismave të tyre në lidhje me BPGj në Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë, Gjakovë, Mitrovicë Veriore dhe Viti. Këto organizata përfshijnë: Organizata për Reforma Lokale (EULOC), Undruženje Poslovnih Žena (WBA), Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (MWAHR), Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YAHR), Iniciativa e Gruas Kosovare si dhe EcoKosWomen. Këto organizata kanë qenë pjesë e tre trajnimeve të mbajtura për rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre mbi BPGj-në si pjesë e nismës rajonale të Rrjetit të Mbikëqyrësve të Buxhetit Gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë. Respektivisht, nismat e tyre janë si vijon: “Monitorimi dhe mentorimi i zbatimit të duhur të politikave gjinore në Komunën e Vitisë”; “Fuqizimi i grave përmes analizës së politikave lokale dhe pjesëmarrjes në buxhetimin gjinor në veri të Kosovës”; “Perspektiva gjinore për planifikim të qëndrueshëm ekonomik”; “Monitorimi dhe analizimi i politikbërjes në nivel lokal nga perspektiva gjinore”; “Buxhetimi gjinor drejt zhvillimit ekonomik të balancuar gjinor”; dhe “Menaxhimi i higijenës menstruale, jetë e pastër për gratë dhe vajzat”.

Përfituesit e granteve kanë punuar me grupe të synuara të ndryshme në Kosovë, por kryesisht me Drejtoritë e Buxhetit dhe Financave në komunat e tyre, si dhe me drejtoritë dhe institucionet e tjera komunale. Me njohuritë e marra mbi BPGj-në gjatë trajnimeve si dhe me mbështetjen e RrGK-së gjatë këtij viti, ata kanë arritur rreth 3600 përfitues direkt dhe indirekt.



RrGK ka vazhduar të avokojë për zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara (OKB) [Treguesi 5.c.1](#), sipas angazhimeve të Kosovës për zbatimin e SDG-ve dhe BPGj-së; si dhe për rekomandimet e paraqitura në Analizën Gjimore Fiskale të Buxhetit nga RrGK [“Pandemia nuk njih gjini?”](#). Është e rëndësishme të theksohet se Pako e Ringjalljes Ekonomike, e bërë publike në qershor, përfshin katër masa pozitive gjimore, që është më shumë se pakot e mëparshme të hartuara ndaj pandemisë COVID-19.

Gjatë diskutimeve publike për ndarjet buxhetore për vitin 2022, [rekomandimet](#) nga këto dy dokumente hulumtuese, ndër të tjerash ai për buxhetim më të përgjegjshëm gjinor në nivel komunal, janë ndarë me anëtarët e RrGK-së. Kështu, anëtarët e RrGK-së kanë pasur rastin të shprehin shqetësimet dhe rekomandimet e përbashkëta të përfaqësuesit e komunës së tyre dhe të ndikojnë në ndarjet buxhetore për vitin e ardhshëm. Për më tepër, në muajin nëntor, RrGK së bashku me UN Women u kanë dërguar [letër](#) secilit deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo letër përfshinë 10 rekomandime konkrete lidhur me institucionalizimin e BPGj-së dhe përfshirjen e tij në procesin buxhetor për vitin 2022.



Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OSHCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE

RrGK ka kontribuar rregullisht në përfshirjen e organizatave anëtare dhe të grave politike në procesin e anëtarësimit në BE. Aktivistët dhe organizatat për të drejtat e grave u inkurajuan dhe u ndihmuan në mënyrë specifike për të dhënë kontribut në Raportin e Progresit të këtij viti. Për më tepër, 50% e këtyre rekomandimeve janë pasqyruar në raportin e këtij viti, i cili ka vazhduar të ketë perspektivë më të mirë gjinore dhe të jetë më gjithëpërfshirës në sektorë të ndryshëm, diçka që ka qenë ndër kërkesat e RrGK-së ndër vite. RrGK gjithashtu ndihmoi shumë organizata të grave, lokale dhe rajonale, për të ofruar rekomandimet e tyre për procesin e konsultimit të TACSO për IPA III; 13 organizata të shoqërisë civile për të drejtat e grave morën pjesë në këto procese, shtatë nga të cilat ishin avokime përgjatë vitit 2021.

Më saktësisht, përgjatë kësaj periudhe RrGK ndërmorri nismat e përbashkëta avokuese të renditura më poshtë:

- OShCG-të ishin substancialisht më të përfshira në diskutime mbi çështjet e ndryshme dhe proceset politike, përfshirë dialogun politik, sidomos në kuadër të strukturave të MSA-së.
- RrGK konsultoi OShCG-të për të marrë kontributin e tyre në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, të vitit 2021.
- RrGK kontriboi me rekomandime konkrete për Agjendën e Reformave Evropiane – Plan i Vepromit, në kuadër të platformës për konsultime publike.



- RrGK u dërgoi rekomandimet e dhëna për ARE II zyrtarëve të zyrës së BE-së në Kosovë, përkatësisht, rekomandimet i'a dërgoi: Ereza Pula - Pikës Fokale për Barazi Gjinore; Reyes Charle Cuellar, EUO Këshilltare Gjinore; dhe Maria Berishaj Sylejmani, EUO, Zyrtare për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e grave, divizioni politik.
- RrGK ofroi rekomandimet për Udhëzimet Strategjike të Drejtoratit të Përgjithshëm për Fqinjësi dhe Zhvillim, lidhur me mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në regjionin e shteteve në Zgjerim (2021-2027).
- Komentoi në Opinionin e Komisionit për Punë të Jashtme për Komisionin për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore në lidhje me Barazinë Gjinore në politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së (2019/2167(INI)), që u nda me RrGK nga Hannah Neuman, e cila e falënderoi RrGK për kontributin e dhënë. RrGK gjithashtu ka pranuar një shënim falënderues nga Anne Morin, nga Komiteti i Këshilltarëve politikë për Marrdhënie të jashtme, dhe Nën-komiteti për Siguri dhe Mbrojtje, e cila ka treguar mirënjohje për punën e RrGK-së, duke e quajtur atë si “punë dhe kontribut tejet i kuptueshëm për informimin e Opinionit”, duke shtuar se kontributi i RrGK do të jetë shumë relevantë dhe do ta informojë edhe punën e parlamentit në lidhje me PVGj III.
- RrGK ka përfshirë perspektivë gjinore edhe në draft-Strategjinë e Kosovës për Sundim të Ligjit, për të informuar Strategjinë sidomos në raport me Dhunën me Bazë Gjinore, duke përdorur edhe rekomandimet paraprake të cilat RrGK i kishte dërguar për Raport te Komisioni Evropian për Kosovën.



- RrGK komentoi dhe përfshiu perspektivë të theksuar gjinore në draft-Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, duke theksuar vëmendje në nevojën për eliminim të stereotipeve negative të cilat po përforcoheshin përmes draftit ekzistues. Në lidhje me këtë proces, RrGK konsultoi një profesionist të shërbimeve sociale dhe strehimoret në Kosovë, për të përforcuar rekomandimet duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji.
- RrGK ngriti vetëdijën për procesin e hartimit të Planeve në Nivel Vendi për Zbatim të PVGJ III & organizoi takime konsultative me OShCG dhe OSHC në lidhje me hartimin e këtij plani, duke mbledhur kontributet e organizatave pjesëmarrëse;
- Përgatiti kontribute për Raportin e Lobit Evropian i Grave të Evropës Qëndrore Lindore, shteteve Baltike, shteteve të Ballkanit & Turqisë (CEEBS) , në bashkëpunim me Qendrën e Grave Autonome në Serbi dhe me anëtarët e Rrjetit joformal regional për adresimin e dhunës në baza gjinore, në lidhje me fondet për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor.
- Avokoi për harmonizimin e Draft-Kodit Civil me Acquis të BE për Barazi Gjinore, dhe me praktikat më të mira për të siguruar barazinë gjinore, të drejtat e grave, të drejtën në martesë, dhe për të ndaluar çfarëdo lloj diskriminimi në bazë të seksit apo gjinisë.
- RrGK po ashtu morri pjesë në gjashtë takime konsultative, në kuadër të strukturave të MSA-së: MSA NK – Takimi mbi Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë (dy takime të ndara, me BE-në dhe me qeverinë); MSA NK – Takimi mbi Transportin, Ambientin, Energjinë dhe Zhvillimin Regjional; MSA NK – Takimi mbi Agrokulturë dhe Peshkatari; MSA NK – Takimi mbi tregtinë, Industrinë, NVM-të, Lirinë e Qarkullimit të mallrave, Traditat dhe Zakonet;

- RrGK konsultoi anëtarët për çështjet që duhej ngritur në javën e avokimit me BE 2021; Rekomandimet e anëtareve u ndanë me zyrtarët e BE-së gjatë takimeve;

OSHCG-të dhe gratë janë më të informuara rreth proceseve të anëtarësimit në BE, rolin e tyre dhe si të angazhohen

Pas miratimit të Planit të ri të Veprimit Gjinator të BE-së (GAP) III , më 25 mars RrGK mbajti punëtori mbi ngritjen e kapaciteteve me 32 pjesëmarrës nga 17 OShCG. Punëtorja u drejtua nga Nicole Farnsworth, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimit në RrGK, e cila gjithashtu ka vazhduar të shërbejë si eksperte në BE sipas kontratës me RrGK-në. Kjo i ka ofruar RrGK-së njohuri dhe ekspertizë të shtuar në lidhje me GAP III dhe proceset përkatëse të BE-së, të cilat RrGK u përpoq t'i ndajë me aktivistët e tjerë në rajon, si të rëndësishme për punën e tyre (gjithmonë në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe lejet e pranuar paraprakisht nga EUOK). Qëllimi i punëtorisë ishte që të fuqizojë aktivistët që të angazhohen në mbështetjen, monitorimin dhe avokimin për zbatimin e GAP III. Pjesëmarrësit u njoftuan me natyrën e GAP III, si një dokument pune i stafit; objektivat dhe treguesit e tij; përafrimin dhe harmonizimin e tij me angazhimet e tjera të politikave të BE-së; Detyrimet e delegacioneve të BE-së që rrjedhin nga GAP III, të tilla si kryerja e proceseve të konsultimit; përgjegjësitë e shteteve anëtare të BE-së; dhe mundësitë për angazhimin e shoqërisë civile. Pjesëmarrës të punëtorisë ishin të gjitha organizatat partnere të nismës "Përfshirja Gjimore në Procesin e Anëtarësimit në BE", të bashkëfinancuar nga BE dhe Sida, si dhe OShCG të tjera të rajonit të interesuara në këtë temë. Organizatat pjesëmarrëse veçanërisht



përfaqësonin interesat e të rinjve, grupeve etnike të pakicave, përfshirë romët, dhe personave të cenueshëm, duke përfshirë gra që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore.

Me 15 Maj, RrGK ka udhëhequr një punëtori për gratë me aftësi të kufizuara, bashkë me organizatën e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës (OPDMK). Të gjitha pjesëmarrëset ishin gra me aftësi të kufizuar nga zona të ndryshme gjeografike të Kosovës, të cilat mësuan më shumë për mënyrat e avokimit në kuadër të integritit gjinor në politika publike dhe në proces të para anëtarësimit në BE, me fokus në ndjeshmërinë gjinore në këto procese.

Pjesëmarrëset identifikuan qëllime të avokimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar për të avokuar edhe më tej për përmirësimin e kornizës ligjore të personave me aftësi të kufizuara. Punëtorja u mbajt me 18 pjesëmarrëse dhe u mbështet nga zyra e BE-së në Kosovë, përmes nismës “Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në Politikë”.

Më 29 Korrik, RrGK dhe partnerët e nismës rajonale “Avancimi i Barazisë Gjinore në procesin e para-anëtarësimit në BE” mbajtën një punëtori për monitorimin e procesit të para-anëtarësimit nga perspektiva gjinore, gjatë së cilës diskutuan për metodologjinë e monitorimit



Punëtorja e RrGK-së me gratë me aftësi të kufizuara, maj 2021

dhe indikatorët përkatës. Qëllim i kësaj punëtorie ishte që partnerët me më pak përvojë me monitorim të këtyre proceseve dhe indikatorëve, të mësonin më shumë për këto procese. Punëtorja kishte qëllim që partnerët të formonin një qasje të përbashkët të monitorimit, si dhe t'i caktojë hapat e ardhshëm të monitorimit në lidhje me secilin dimension dhe indikator. Partnerët diskutuan mbi rreziqet dhe sfidat e mundshme, si dhe mënyrat për t'u bërë ballë atyre. Njohuria e përfituar nga kjo punëtori do të përdoret nga RrGK dhe partnerët për të përmirësuar procesin e monitorimit të perspektivës gjinore në proces të para-anëtarësimit në BE.



Përmirësimi i njohurive dhe të kuptuarit e palëve të interesit në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE

RrGK vazhdoi avokimin drejt avancimit të njohurive dhe kuptimit të palëve të interesuara për rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE. Kjo u arrit përmes letrave e takimeve avokuese, dhe rekomandimeve përmes procesit të konsultimit publik mbi politikat e shumta publike. RrGK gjithashtu angazhoi OShCG-të në përfshirjen gjinore të Planit të Veprimit ARE II, Raportin e Progresit për vitin 2021 dhe në rekomandimet mbi gjashtë takime të ndryshme të MSA-së. Këtë vit, avokimi i RrGK-së në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE kishte për audiencë zyrtarë qeveritarë të rinjë e të ndryshëm. Ata çmuan lart punën e RrGK-së si dhe u zotuan për përfshirjen përmbajtësore të më shumë OShCG-ve, duke përfshirë këtu RrGK-në, në bërjen e politikave sa herë që kërkohet përfshirja e ekspertëve të shoqërisë civile.

Përgjatë javës së avokimit, të organizuar nga Kvinna till Kvinna, RrGK takoi Plamena Halacheca, Drejtuesen e Sektorit për Integritet Evropian, çështje politike, media dhe informacion të Delegacionit

Kosova mund të jetë shembulli më i mirë në rajon, e ndoshta edhe në botë, për mënyrën se si të përfshihen dhe të kompenzohen organizatat e grave, dhe si t'u njihet kontributi, nga Delegacionet e BE-së” -

Përfaqësuesja nga DG NEAR

të BE-së në Mal të Zi, si dhe përfaqësuesen e DG NEAR. Gjatë këtyre takimeve, RrGK u veçua si shembulli më i mirë lidhur me atë se si gratë mund të përfshihen në procesin e anëtarësimit në BE. Përfaqësuesja nga DG NEAR çmoi përvojën dhe kontributin e RrGK-së të ofruar për draftimin e PVGj III në Kosovë. Përmirësime të tjera që janë vërejtur në lidhje me angazhimin e grave në procesin e anëtarësimit në BE, janë:

- Përmirësime në proceset e konsultimit publike, veçanërisht nga BE-ja, pasi agjendat gjithmonë u ndanë paraprakisht, dhe zyrtarët e BE-së me të cilët RrGK u takua, e siguruan RrGK-në se çështjet që RrGK ngrii do të ngrihen patjetër gjatë takimeve të MSA-së të BE-së me qeverinë.
- ZBE-ja dhe qeveria u konsultuan me RrGK-në në lidhje me Programin e publikuar të Reformës Ekonomike 2021-2023, i cili u konsultua me RrGK nga ZBE dhe qeveria ka treguar perspektivë gjinore në rritje, veçanërisht në krahasim me atë të mëparshme në listën e programeve të tilla të hartuara nga ERP. Duke përfshirë kontributin e konsiderueshëm të RrGK-së, por edhe si vazhdimësi e rekomandimeve të mëparshme, ka përfshirë një qasje të përmirësuar, më të mirë gjinore, bazuar në mësimet e nxjerra nga vitet e mëparshme kur RrGK kishte dhënë rekomandime.
- Është publikuar Opinioni i Komisionit për Punë të Jashtme për Komisionin për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore për Barazinë Gjinore në politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së (2019/2167(INI)), duke përfshirë 80% të komenteve, vërejtjeve dhe rekomandimeve të RrGK.
- Ministria e Drejtësisë u zotua të bëjë ndryshime aktuale në Projekt Kodin Civil, bazuar në rekomandimet e RrGK-së që kodi të jetë më i harmonizuar me Acquis të BE-së për Barazinë

Gjinore dhe praktikat më të mira, duke eliminuar dispozitat që rrezikojnë të drejtat e grave, të drejtat pronësore dhe martesën. Dispozitat për ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe seksualitetit janë ende në diskutim me grupin e punës të Kodit Civil;

- U publikua Plani i Veprimit ERA II, duke përfshirë pjesën më të madhe të rekomandimeve nga RrGK si rrjedhojë e konsultimeve me qeverinë e Kosovës.

Përmirësimi i integritetit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre

RrGK vazhdoi angazhimin mbi perspektivën gjinore në dokumentet publike në nivel qendror, si dhe lidhur me procesin e Anëtarësimit në BE, përfshirë nivelin ndërkombëtar. Këtë vit, RrGK ka komentuar gjithsej në 12 politika, përfshirë katër prej tyre që kanë të bëjnë me anëtarësimin në BE:

1. Procesi i konsultimit për Instrumentin e Ndihmës Para-Anëtarësimit (IPA III)
2. Plani në Nivel të Shtetit për Implementimin e PVGJ III
3. Raporti i Progresit të Kosovës 2020 (së bashku me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore)
4. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024
5. Draft Agjenda për Reforma Evropiane II – Plani i Veprimit
6. Draft Ligji mbi Strategjinë e Ligjit
7. Draft Ligji mbi Shërbimet Sociale
8. Draft Ligji mbi Mbrojtjen nga Dhuna në Baza Gjinore

9. Draft Ligji mbi Financat e Qeverisjes Lokale
10. Angazhimi në Draft Manualin dhe Udhëzuesin Strategjik të Direktivave për mbështetjen e BE-së ndaj Shoqërisë Civile në rajonin e zgjerimit 2021-2027
11. Draft Rregullorja Nr. XX/2021 mbi Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publik.
12. Draft Ligji për Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e vitit 2022

Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarëve të BE-së, Zyrës së Kryeministrit - Strukturave të Integrimit Evropian, Mekanizmave Kombëtar për Barazi Gjinore si dhe ministrive të linjës lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet relevante për anëtarësimin në BE

RrGK ka vazhduar ofrimin e ndihmës teknike për BE-në në Kosovë në lidhje me proceset e integrimit të çështjeve gjinore, dokumentet e veprimit, kontratat dhe dokumentet tjera përkatëse. RrGK ka ofruar ngritjen e kapaciteteve si dhe rishikime të drejtpërdrejta dhe sugjerime në dokumente të ndryshme të BE-së. RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e saj me strukturat e Ministrisë së Integrimit Evropian, të shkruara në Zyrën e Kryeministrit. Njohuritë e tyre mbi integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e anëtarësimit në BE janë përmirësuar si rezultat i këtij bashkëpunimi, përfshirë edhe procesin e konsultimit publik. Dokumentet e anëtarësimit në BE tregojnë përmirësim të dukshëm në masën në të cilën ato i kanë integruar çështjet gjinore, megjithëse nevojiten përpjekje të mëtejme për të zbatuar zotimet.



Gjatë një takimi me Shoqërinë Civile në lidhje me Agjendën e Reformave Evropiane – Planin e Veprimit, zëvendëskryeministri i parë dhe përfaqësues i Kosovës për dialog, Besnik Bislimi, falënderoi veçanërisht RrGK-në për kontributin e dhënë në integrimin e perspektivës gjinore në procesin i anëtarësimit në BE, dhe tregoi përkushtimin që të konsultohet me RrGK për shënjimin e OShCG-ve në nivel lokal, të cilat mund të kontribuojnë, për një proces më të mirë dhe më gjithëpërfshirës të konsultimit të shoqërisë civile. Përveç kësaj, disa përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, kanë shprehur vlerësimin e tyre për Barazinë Gjinore dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor dhe Trajnimet e Integritimit Gjinor që RrGK ka ofruar për BE-në këtë vit, duke vërejtur përmes vlerësimeve anonime se njohuritë dhe kapacitetet e tyre janë rritur.

RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), si mekanizmi kryesor i barazisë gjinore në Kosovë. RrGK vazhdimisht ka përditësuar ABGJ-në rreth iniciativave dhe avokimit në lidhje me përfshirjen e barazisë gjinore në procesin e para-anëtarësimit në BE.



Puna e RrGK-së u njoh në takimin me Shoqërinë Civile në lidhje me Agjendën e Reformës Evropiane - Planin e Veprimit, nëntor 2021

Përmirësimi i aftësisë së komisioneve të ndryshme, sidomos komisionit për integrimin në BE, dhe OShCG-ve, për të monitoruar zbatimin nga perspektiva gjinore

Në lidhje me këtë, RrGK ka përdorur proceset e konsultimit me nën-komisionet e MSA-së për të avokuar për përmirësimin e perspektivës gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE, veçanërisht në lidhje me shpërndarjen e fondeve të ardhshme të IPA-s, çështjet e adresuara në Raportet e Progresit të Kosovës dhe zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325, për të informuar Strukturat e MSA-së që përfaqësojnë Kosovën dhe BE-në gjatë takimeve për MSA-në. Me shumë detaje në lidhje me këtë mund të gjenden në kapitullin më lart, në lidhje me *Rritjen dhe Përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në procesin e paraanëtarësimit në BE*.

Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II

Drejt zbatimit të Planit të Veprim Gjinor të BE-së (PVGJ) II, RrGK ka punuar drejt arritjes së rezultateve në vijim.

Rritja e mëtëjshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve të BE-së lidhur me nevojën për angazhim më të fuqishëm politik, buxhet të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGJ II.

Në lidhje me vetëdijësimin e zyrtarëve të BE sa i përket zbatimit të PVGJ III, RrGK ka vërejtur përmirësim të dukshëm këtë vit, duke qenë se zyra e BE në Kosovë bashkë me RrGK kanë koordinuar hartimin e



Planeve në Nivel Shteti për të orientuar zbatimin e PVGJ III. Kjo është bërë në kuadër të një kontrate të angazhimit të RrGK me zyren e BE-së, përmes së cilës RrGK ofron asistencë dhe udhëzim në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në programim dhe dialog politik, sidomos në lidhje me zbatimin e PVGJ III dhe integrimin e perspektivës gjinore në IPA III. RrGK mbështeti zyren e BE-së në organizimin e sesioneve konsultuese me akterë të ndryshëm, dhe mbledhi kontributet e tyre, përfshirë Përfaqësuesin Special të BE-së për Kosovë (EUSR), Misioni për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Shtetet anëtare të BE-së, Agjencitë e KB, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim me Evropë (OSCE), NATO, KFOR, dhe akterë të tjerë. Ky proces i konsultimit i kontriboi këtyre akterëve në ngritjen e vetëdijes kundrejt PVGJ III dhe mundësive të zbatimit të këtij dokumenti në Kosovë.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve përkatës lidhur me reformat që kërkojnë për dokumentet dhe shabllonet, drejt përmirësimit të zbatimit të PVGJ III

RrGK i shkëmbeu katër përmbledhjet e sipërpërmendura të politikave me zyrtarët përkatës nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIIGE) dhe delegacioni i BE-së në Kosovë. Në këtë mënyrë, RrGK rriti ndërgjegjësimin e zyrtarëve përkatës në lidhje me reformat e nevojshme, bazuar në rekomandimet e dokumenteve. Me publikimin e GAP III, RrGK ka vërejtur se kontributi i OShCG-ve është marrë kryesisht parasysht. CLIP-et janë hartuar gjithashtu në bazë të rekomandimeve të RrGK-së. Kjo pasqyrohet në fushat tematike të angazhimit dhe objektivat nga GAP III që janë përzgjedhur për Kosovën, në dokumentin e sapopublikuar të CLIP nga ZBEK. Ato janë të harmonizuara me draftin e Kornizës së Programimit IPA III dhe përfshijnë një vëmendje të

konsiderueshme ndaj ndërthurjes, pasi të gjitha referencat ndaj "diversitetit" në objektiva nënkuptojnë se BE-ja do të marrë parasysh pozicionet dhe nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve të zonave të ndryshme gjeografike, etnive, aftësive, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, ndër të tjera. Siç u përmend, trajnimet e ofruara për ZBEK gjithashtu kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të tyre për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të personelit të BE-së dhe ShA-ve lidhur me PVGj II dhe zbatimin e tij

Në vitin 2021, RrGK vazhdoi të punojë ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë drejt zbatimit të PVGj III. RrGK ofroi ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë mentorimin, stërvitjen dhe trajnimin për tema të ndryshme që lidhen me PVGj III. Siç u përshkrua më lartë, RrGK ishte përfshirë në mënyrë aktive në procesin e hartimit të CLIP-ve. RrGK dhe disa palë të interesuara kanë vënë në dukje se përvoja e RrGK me ZBEK në lidhje me CLIP duhet të përmendet si një praktikë e mirë nga e cila mund të mësojnë të tjerët në botë, pasi BE-ja ka shfrytëzuar ekspertizën e RrGK-së si aktiviste, ka siguruar përfshirjen e shoqërisë civile dhe ka kompensuar RrGK-në për kohën dhe ekspertizën e ofruar, duke njohur punën tonë si ekspertë në këtë fushë.



Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit në radhët e OShCG-ve dhe MKBGj-ve lidhur me PVGj-në dhe mënyrën se si të përkrahet zbatimi i tij

Gjatë muajit mars 2021, RrGK mbajti punëtorinë “Hyrje për aktivistët në PVGj III”. Punëtorja ishte e hapur për pjesëmarrje për të gjitha organizatat partnere të RrGK-së, anëtarët e RrGK-së dhe OShCG-të në Kosovë. RrGK informoi pjesëmarrësit për aspektet kryesore të PVGj III. Ata u njohën me shtyllat, përfshirë fushat tematike, dhe në mënyrë specifike u informuan për afatet kohore dhe pikat hyrëse që mund të përdoren nga PVGj III për avokim, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Përmirësimi i projektimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II

Në vitin 2021, RrGK vazhdoi punën e nisur në këtë drejtim, duke përfshirë progresin drejt objektivave përmes rezultatit në vijim:

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit lidhur me përmirësimet e nevojshme në PVGj III

Në drejtim të këtij objekti, RrGK konsideron se PVGj III i publikuar në vitin 2021 ka treguar përmirësime të konsiderueshme, dhe ka inkorporuar shumë rekomandime të cilat RrGK ua ka përcjellë zyrtarëve relevantë të BE-së, të cilat janë cekur edhe në përmbledhjen e politikave “Duke ndjekur BE-në. Angazhimet për Barazinë Gjinore: Mësimet e nxjerra nga PVGj II për të informuar PVGj III”. RrGK gjithashtu po kërkonte në mënyrë aktive harmonizimin e Rregullores së BE-së për Instrumentin e Para-

Anëtarësimi me PVGj III, dhe rregullorja e sapopublikuar gjithashtu ka marrë parasysh disa nga rekomandimet që janë përfshirë në dokument.

Përmirësimi i transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës
RrGK vazhdimisht monitoron transpozimin e Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës, si një nga kushtet kryesore për avancimin e procesit të anëtarësimi të Kosovës në BE. RrGK ka komentuar në disa dokumente thelbësore të lidhura me anëtarësimin në BE, duke sugjeruar transpozim më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore, në veçanti të direktivave të BE-së për të drejtat e grave, shtatzëninë dhe barazisë gjinore, me fokus në direktivën e BE-së për ekuilibrin punë-jetë. Megjithëse këto rekomandime janë pasqyruar dhe përfshirë në disa politika, ka ende mungesë të zbatimit. RrGK do të vazhdojë të monitorojë dhe avokojë për zbatimin e tyre si dhe traspozimin e Acquis mbi Barazinë Gjinore në Ligjet e Kosovës.

ABGj, ZKM- Strukturat e Integritimeve Evropiane dhe MFPT të informohen më mirë në lidhje me nevojat për përmirësimin e transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës

RrGK ka dhënë kontribut të rëndësishëm drejt transpozimit më të mirë të Acquis së BE-së për Barazinë Gjinore, gjatë hartimit të Projektligjit për Shërbimet Sociale. Zyra e Departamentit të Integritimeve Evropiane në kuadër të zyrës së Kryeministrit u informua vazhdimisht për nevojat e transpozimit gjatë bashkëpunimit për hartimin e ERA-s, PKZMSA-së dhe në takimet konsultative të MSA-së. RrGK ka mbajtur shumë takime avokuese me MPMS-në, për t'i informuar për transpozimin më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në lidhje me Projektligjin e Punës.



Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është t'u sigurojë grave qasje në kujdes shëndetësor cilësor të përballueshëm. Përderisa shëndeti riprodhues i grave duket se është në qendër të shumicës së aktiviteteve për zhvillim, RrGK e konsideron shëndetin e përgjithshëm të grave po aq të rëndësishëm. Gjersa burimet për përmirësimin e qasjes së grave në kujdesin shëndetësor cilësor mbeten ende të kufizuara, megjithatë anëtarët e RrGK-së të mbështetura nga RrGK kanë arritur përparim drejt këtij objekti përmes disa nismave të cilat janë në realizim e sipër. Më tej, RrGK ka mbledhur fonde për të siguruar më shumë fonde dhe mundësi për anëtarët e saj me qëllim që të mbështesë punën e tyre në këtë qëllim. Kjo vlen veçanërisht në këtë kohë kur pandemia COVID-19 ka nxjerrë në pah sfidat e ndryshme me të cilat gratë përballen në sigurimin e kujdesit shëndetësor cilësor. Për këtë, RrGK me krenari raporton se ka siguruar mbështetje nga Zyra e BE në Kosovë dhe ADA, dhe së fundi ka ofruar grante për anëtarët për të punuar në këtë fushë. Rezultatet e këtyre nismave do të raportohen në vitin 2022.

Jeta pa dhunë me bazë gjinore

Qëllimi kryesor i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë pa dhunë me bazë gjinore. Drejt kësaj, pas avokimit të pandalur të RrGK dhe anëtareve të saj, me 25 shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kështu zyrtarisht duke përfshirë dhe duke e bërë direkt të zbatueshme Konventën e Këshillit të Evropës në parandalimin dhe luftimin e dhunë ndaj grave dhe dhunës në familje, gjithashtu e njohur edhe si Konventa e Stambollit. Konventa vendosë standarde për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ajo poashtu njih obligimin e shteteve që ta adresojnë plotësisht dhunën me bazë gjinore dhe të gjitha format e saj, si dhe të marrin masa në parandalimin e dhunës ndaj grave, të mbrojnë viktimat dhe të ndjekin penalisht kryesit e veprës. Ky ishte rezultat shumë i rëndësishëm i RrGK-së dhe anëtareve të saj, i cili u arrit ndër të tjerash përmes avokimit të pandalshëm.

Këtë vit RrGK vazhdoi këtë sukses duke avokuar për miratimin e ligjeve dhe politikave të reja në përputhje me Konventën e Stambollit, siç detajizohet më poshtë, në këtë seksion. Përveç kësaj, RrGK ofroi mbështetje ligjore falas për 38 gra të mbijetuara të DHBGJ-së dhe i referoi në institucionet përkatëse.



Përmirësimi i zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në familje, duke përfshirë përgjegjësinë institucionale për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë



Më 28 prill 2021, RrGK ka lansuar raportin e pestë monitorues për DHBGj-në në Kosovë, “[Nga Ligjet në Vepra](#)”. Raporti hulumtues përfshin gjetjet nga intervistat e kryera me institucionet që janë përgjegjëse për trajtimin e dhunës me bazë gjinore sipas Kodit Penal, Procedurave Standarde të Veprimit, Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016-2020 (SKPV), dhe korniza të tjera përkatëse ligjore. Intervistat janë kryer me strehimore, polici (rurale dhe urbane), gjyqtarë, prokurorë, mbrojtës të viktimave, qendra të punës sociale, financues të përfshirë në GBV, mjekë, infermierë, Agjencinë e Kosovës për Mjekësi Ligjore, Institutin e Kosovës për Administratë Publike, OShC të ndryshme, përfaqësues të ministrive dhe komunave në të shtatë rajonet e Kosovës.

Në përgjithësi, nga ky hulumtim vërehen disa përmirësime në njohuritë dhe qëndrimet e institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore, krahasuar me monitorimin e fundit të realizuar në vitin 2017. Megjithatë, ende nuk ka kuptueshmëri të mjaftueshme të dhunës me bazë gjinore, e veçanërisht të asaj seksuale. Fajësimi i viktimës vazhdon ende.

Përpjekjet për të “pajtuar” çiftin “për të ruajtur familjen” dhe shkeljet e konfidencialitetit ende mbizotërojnë në rastet e dhunës në familje. SKPVDHF u zbatua vetëm pjesërisht. Po ashtu, trajtimi i duhur u pengua edhe nga ndarjet e pamjaftueshme të buxhetit.

Siç u përmend, përmes ndihmës juridike, RrGK ka mbështetur gratë që të kërkojnë drejtësi për dhunën që kanë përjetuar, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore përkatëse. Ekipi i DhBGJ-së ka mbështetur 38 raste, duke i informuar gratë për të drejtat e tyre, institucionet ku mund të drejtohen si dhe duke i referuar ato te avokati për ndihmë juridike. RrGK gjithashtu vazhdoi të mbështesë dy raste strategjike gjyqësore që filluan në vitin 2020. Gratë u referuan në institucionet përkatëse të drejtësisë, si dhe te psikologë të strehimoreve për këshillim. Gjithashtu, RrGK angazhoi një monitoruese të gjykatave, e cila i ndoqi rastet e DhBGJ në gjykata, kjo drejtë identifikimit të rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore.

Si rezultat i avokimit të vazhdueshëm të RrGK për mbështetjen e strehimoreve, në vitin 2021, Qeveria ka ndarë 900,000 € për të gjitha strehimoret, ndërsa për vitin 2022, Qeveria ka ndarë 1,000,000€ për linjën buxhetore “Shërbimet themelore për strehimoret”. Këto janë arritje të rëndësishme drejt zbatimit të kuadrit ligjor.



Zgjerimi i njohurive në lidhje me shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje, si dhe vetëdijesimi rreth mbizotërimit të dhunës në familje

Siç u përmend, në prill të vitit 2021, RrGK lansoi raportin hulumtues “Nga Ligjet në Vepra!”, i cili informon RrGK-në dhe palët relevante të interesit për ndryshimet në njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme që nga viti 2015. Bazuar në gjetjet, RrGK organizoi iniciativa avokuese, për të siguruar që përfaqësuesit institucionalë dhe OSHC-të që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat që kanë vuajtur nga DhBGj, të kenë njohuri të shtuara. Për këtë qëllim, RrGK organizoi 39 takime me akterë të ndryshëm për të avokuar për zbatimin e kornizës ligjore, duke përfshirë rekomandimet e hulumtimit.

Institucionet dhe akterët e tjerë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën korniza ligjore për dhunën në familje është zbatuar

Për të informuar palët e interesuara për zbatimin e kornizës ligjore dhe për të siguruar zbatimin e duhur të saj, RrGK ka mbajtur takime avokuese me institucionet në vijim: Ministrinë e Drejtësisë; Zëvendësministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministrinë e Financave, konkretisht Drejtorinë e Departamentit për Familje dhe Shërbime Sociale; Shefin e Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave; dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile, si Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Kallxo.com etj. për të avokuar për përmirësimin e reagimit ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, për të ndarë dhe diskutuar gjetjet dhe rekomandimet për secilin institucion si dhe për të diskutuar mundësitë për bashkëpunim në adresimin e DhBGj-së, përmes drejtësisë, shërbimeve sociale dhe arsimit. Për më tepër, puna e RrGK-së në këtë fushë u përmend në 250 artikuj të mediave. Tutje, më 9 nëntor, Adelina Berisha,



RrGK takohet me Ministren e Drejtësisë znj. Haxhiu: zotohen për të luftuar dhunën ndaj grave, prill 2021



Menaxhere e Programit për DhBGj në RrGK, ishte e ftuar si paneliste në diskutimin e mbajtur për nder të 10 vjetorit të Konventës së Stambollit, të organizuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, Lobi i Grave Evropiane dhe Sveriges dhe përfaqësues të Suedisë në BE-së si dhe me disa pjesëmarrës nga BE dhe Ballkani Perëndimor. Ajo ka folur për situatën në Kosovë. Janë mbajtur edhe disa takime shtesë me përfaqësuesit e BE-së për t'i informuar ata për statusin dhe nevojat për adresim më të mirë të DhBGj-së në Kosovë, sipas Konventës së Stambollit.

Angazhimi i RrGK-së dhe anëtareve të saj për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

RrGK ka bashkëpunuar me OSHC-të që ofrojnë shërbime, kryesisht me strehimoret, për këshillimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Përmes bashkëpunimit me strehimoret, RrGK promovoi edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ngriti vetëdijen për mekanizmat e ndryshëm ku mund të referohen si të mbijetuarit e dhunës po ashtu dhe ofruesit e shërbimeve për ta. Që nga qershori i vitit 2021, gjithsej, 190 gra dhe fëmijë janë mbështetur, këshilluar dhe referuar nga strehimoret. Çdo grua është informuar për të drejtat e saj dhe rolin e institucioneve. RrGK dhe anëtarët e saj këtë vit gjithashtu morën pjesë në 15 nisma avokuese lidhur me dhunën në familje.

RrGK ishte pjesë e dy takimeve për ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, të drejtuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, Peticione dhe Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës. RrGK ka dhënë kontributin e saj përmes rekomandimeve nga ekspertët e brendshëm dhe të jashtëm të DhBGj-së si dhe ekspertët ligjorë. Ndryshimi i këtij ligji kyç për

të mbuluar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore do të kontribuojë në zbatimin e kornizës ligjore, përkatësisht të zotimeve kushtetuese të Kosovës ndaj Konventës së Stambollit.

Më tej, RrGK ishte pjesë e tri takimeve të Grupit Koordinues Ndërministror kundër Dhunës në Familje, të koordinuara nga Koordinatorja Nacionale kundër Dhunës në Familje nga Ministria e Drejtësisë. Prania e RrGK-së në këto takime lehtëson monitorimin e punës së të gjitha institucioneve përgjegjëse për trajtimin e dhunës në familje, kjo drejt zbatimit të kornizës ligjore përkatëse.

Përveç kësaj, RrGK po ashtu ka vazhduar monitorimin e rasteve të DhBGJ-së të cilat janë adresuar në Gjykata Themelore, kryesisht në Prishtinë, por edhe në komunat e tjera sipas nevojës. Deri në mes të nëntorit, RrGK ka monitoruar 55 raste. Nga monitorimi mund të dalin edhe rekomandime që mund të përmirësojnë e zbatimin e kuadrit ligjor.

"Jam 100% e sigurtë që pa prezencën e monitorueses së RrGK-së rasti im kurrë nuk do të trajtohej mirë ashtu siç është trajtuar. Prezenca e saj më japi vetëbesim si dhe siguroi trajtim ashtu siç duhet nga gjykatësi, për këtë do të jam falënderuese gjithmonë." – Grua, e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore.



Rritja e performancës dhe cilësisë së shërbimeve të strehimoreve, veçanërisht atyre për rehabilitim dhe riintegrim


RrGK, në konsultim me strehimoret dhe së bashku me Qendrën Autonome të Grave në Serbi, ka zhvilluar një protokoll të ri tele-këshillimi për të mbështetur gratë që kanë përjetuar dhunë. Protokollin është një udhëzues praktik për ofruesit e shërbimeve online për gratë që kanë përjetuar dhunë. RrGK organizoi sesione për të diskutuar protokollin me ofrues të ndryshëm të shërbimeve në Kosovë (p.sh., punonjës socialë dhe psikologë në strehimore dhe qendra ditore). Protokollin përfundimtar do të kontribuojë në avancimin e kapaciteteve të tyre në qasjet më të mira të tele-këshillimit, drejt ofrimit të shërbimeve më të mira për gratë të ndryshme.

Që nga viti 2012, RrGK ka avokuar për buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme për strehimoret për të mbrojtur gratë dhe fëmijët që kanë pësuar dhunë. Pas avokimit nga RrGK, strehimoret dhe qendrat ditore, parlamenti i Kosovës ndau buxhet për strehimoret dhe qendrat ditore. Më 25 nëntor, parlamenti miratoi buxhetin për vitin 2021, i cili përfshin 1,000,000 € për strehimoret dhe qendrat ditore në Kosovë.

Më tej, organizata anëtare e RrGK Zensko Pravo me bazë në Mitrovicën e Veriut, e cila ofron mbështetje ligjore dhe psikologjike për të mbijetuarit e DhBGj-së, në fillim të vitit 2021 rrezikonte të mbyllej për shkak të mungesës së mbështetjes financiare dhe politike nga qeverisja komunale. RrGK i ndihmoi për të paguar qiranë me fonde emergjente.



Përmirësimi i vetëdijesimit dhe vëmendjes në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve, në trajtimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual



Fushata online e RrGK-së në bashkëpunim me Gjirafën për ndërgjegjësimin e qytetarëve për DHBGJ, 2021

Siç u përmend, monitorimi i RrGK-së ka treguar se ndërgjegjësimi i zyrtarëve është përmirësuar në lidhje me dhunën në familje, edhe pse nevojiten ende përmirësime, veçanërisht në lidhje me format e tjera të DHBGJ-së. Në vitin 2021, dy nga rekomandimet kryesore të dala nga raporti: “Nga Ligjet në Vepra” u pranuan për t’u futur në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe në Strategjinë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Këto dy rekomandime kërkojnë që Ligji aktual të amendamentohet, për të përfshirë të gjitha llojet e dhunës në baza gjinore dhe dhunës ndaj grave, në pajtim me Konventën e Stambollit. Po ashtu, deri në nëntor, RrGK kishte më shumë se 136 raste të mbulimit

mediatik, gjë që ngriti vetëdijen e qytetarëve për dhunën me bazë gjinore. Po ashtu, RrGK pati disa fushata vetëdijësuese edhe përmes rrjeteve sociale.

Ashtu si përgjatë viteve të kaluara, më 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, RrGK iu bashkua protestës “Marshojmë s’festojmë kundër patriarkatit që vret”. RrGK edhe një herë iu bashkua këtij marshimi, i cili u mbajt edhe në 14 komuna të tjera nëpër Kosovë. Qytetarët ngritën zërin kundër padrejtësive ndaj grave dhe pankarta me mesazhe feministe shiheshin në ballkonet e tyre.

Më 17 mars, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në bashkëpunim me RrGK-në publikoi të gjeturat për hetimin e vrasjes së Sebahate Morinës “Shteti me mosveprim e privon nga jeta Sebahate Morinën”. Po ashtu, në korrik të vitit 2021 vajza e të ndjerës Sebahate Morina, ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, kërkesën me të cilën propozohet të konstatohet se me mungesën e veprimeve të autoriteteve shtetërore është cenuar e drejta për jetë e garantuar me Kushtetutë. Kërkesa është përgatitur në bashkëpunim ndërmjet RrGK-së dhe Qendrës për Ndihmë Juridike Falas të Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Më 16 korrik 2021, RrGK ka ngritur zërin kundër dhunimit dhe keqtrajtimit të shumëfishtë të së miturës 13-vjeçare nga Janjeva, si dhe ka



*Protestuesit para Qendrës për Punë Sociale në
Lipjan, korrik 2021*

kërkuar përgjegjësi dhe drejtësi për abuzimin zinxhiror që i është bërë asaj, duke protestuar para Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Lipjan. Qytetarë dhe aktivistë të shumtë u bashkuan me thirrjen e RrGK-së për këtë protestë, e cila vazhdoi me marsh deri te objekti i Policisë në Lipjan. “Të monitorohet QPS”, “Dhunuesit në burg” dhe “Vajzat përdhunohen, institucionet heshtin”, ishin disa prej parullave që aktivistët mbanin në duar gjatë protestës.

Po ashtu, më 24 gusht, shumë qytetarë dhe aktivistë iu bashkuan protestës në Ferizaj, për të kërkuar drejtësi për vrasjen e 18-vjeçares me initiale M.O. Protesta u organizua nga RrGK, Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Kuvendi Rinor i Ferizajt. Protesta u mbajt para Stacionit Policor dhe ka vazhduar me marshim para ndërtesës së Gjykatës dhe Prokurorisë në Ferizaj. Me parulla dhe thirrje të shumta për drejtësi protestuesit kërkuar dënimin maksimal për vrasësit e 18-vjeçares.

Më 10 Dhjetor, RrGK bashkë me anëtarët tjerë të Rrjetit për të Drejta të Njeriut, shënuan ditën e të drejtave të njeriut, me një protestë para institucioneve kryesore në Kosovë: Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. RrGK specifikisht kërkoi institucionalizim të mbrojtjes së grave të cilat vazhdojnë të vuajnë dhe të vriten si pasojë e dhunës në baza gjinore. RrGK poashtu kërkoi sanksionim proporcional, llogaridhënie të gjyqtarëve dhe masa disiplinore për të gjitha institucionet që neglizhojnë trajtimin e drejtë të viktimave të dhunës në baza gjinore.



Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre

Deklaratat për shtyp, paraqitjet televizive dhe protestat synojnë të informojnë më shumë njerëz për të drejtat e tyre. RrGK ka mbështetur strehimoret në shërbimet e tyre këshilluese lidhur me të drejtat dhe ka referuar raste te avokati i RrGK-së, sipas nevojës. Siç u përmend, RrGK ka mbështetur 38 raste gjatë kësaj periudhe, duke i informuar gratë për të drejtat e tyre, institucionet në të cilat mund t'i drejtohen dhe duke i referuar ato te avokati për ndihmë juridike, kurse dy raste të kontesteve strategjike janë në vazhdim e sipër që nga viti paraprak. Rreth 1,500 qytetare e qytetarë kanë marrë pjesë në protestat e organizuara nga RrGK-ja.

Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual

Koordinimi mes OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike dhe vendeve tjera të punës është përmirësuar në aspektin e instalimit të mekanizmave më të mirë për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

Aktualisht, Republika e Kosovës është duke e hartuar Strategjinë së Re dhe Planin e Veprimit 2022-2026 për Parandalimin e DHBGJ-së, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, për të cilat RrGK dhe anëtarët kanë dhënë kontributin e tyre bazuar në ekspertizën e tyre. Në këto dokumente po trajtohen të gjitha format e DHBGJ-së, përfshirë edhe ngacmimin seksual. Këto ndryshime në legjislacion do të adresojnë raportimin e mangët dhe hetimin e ngacmimeve seksuale. Për më tepër, RrGK këtë vit filloi të punojë

me punëdhënës të ndryshëm për të vlerësuar politikat e tyre në vendin e punës dhe për t'i mbështetur ata në përdorimin e mekanizmave më të mirë për trajtimin e ngacmimeve seksuale në vend të punës.

Përmirësimi i mbështetjes institucionale dhe publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Së pari, RrGK e ka ngritur këtë çështje në raportin “Një ulëse në tryezë”. Së dyti, RrGK kërkoi mbështetje në disa takime me zyrtarë të BE-së, për të inkurajuar Qeverinë që të zgjasë periudhën gjatë së cilës njerëzit mund të aplikojnë për përfitime si të mbijetuar/a të dhunës sipas ligjit aktual, duke pasur parasysh se mund të duhet kohë që njerëzit të jenë në gjendje ta raportojnë atë; dhe që ligji të ndryshohet për të zgjatuar periudhën e konfliktit, për të përfshirë më mirë përfitimet për gratë e etnive të ndryshme, sipas rekomandimeve të Amnesty International.

RrGK ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të njohur dhe respektuar të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe ka disa organizata anëtare që punojnë në këtë fushë. RrGK ka vazhduar të monitorojë zhvillimet në këtë drejtim.

Në korrik të vitit 2021, Zoran Vukotiq u dënua me 10 vjet burg për ushtrim të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ky është rasti i parë që dikush dënohet për një krim të tillë në Kosovë nga një gjykatë vendore. Prokurorja, Drita Hajdari, e cila punoi ngushtë me këtë rast dhe takoi të mbijetuarën, foli me RrGK për përvojën dhe kontributin e saj, si dhe rëndësinë e raportimit të krimeve seksuale dhe ndëshkimit të fajtorëve. Hajdari u dha një mesazh të mbijetuarve të dhunës seksuale për rëndësinë që ato/ata të flasin dhe të dëshmojnë për përvojat. “Krimi është krim dhe duhet dënuar. Këto vepra penale



nuk janë të parashkruara, prandaj asnjëherë nuk është vonë për t'i paraqitur këto raste para organeve, për të përmbushur detyrimin tonë moral dhe ligjor ndaj të mbijetuarve, si dhe për të sanksionuar autorët e këtyre veprave penale”, tha Hajdari. Ky artikulli i shkruar RrGK solli sërish në sferën publike temën e dhunës seksuale të ushtruar gjatë luftës dhe shërbeu si mjet për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.

RrGK dhe anëtalet e saj përkrahin personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Përmes FGK-së, RrGK ka mbështetur organizatat anëtare të cilat ofrojnë shërbime për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës. Këto organizata anëtare të RrGK-së vazhduan të mbështesin personat që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës. Konkretisht, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave mori mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës për të ofruar “shërbime psiko-sociale për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë”, nismë kjo e cila është në zbatim e sipër.

Fuqizimi Ekonomik i Grave

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike. Siç ilustron më poshtë, janë ndërmarrë disa hapa për realizimin e këtij qëllimi.

Përmirësimi i kushteve për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore

Gjatë vitit 2021, RrGK së bashku me organizatat e saj partnere dhe anëtarët e Koalicionit Rajonal kundër Diskriminimit me Bazë Gjinore ndaj Grave në Punë, vazhduan adresimin e diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës. Ata vazhduan avokimin për ndryshime të politikave drejt përmirësimit të kushteve për trajtimin e barabartë të grave dhe burrave në punë, rezultatet e të cilave do të raportohen në vitin 2022.

Përveç kësaj, RrGK së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës të mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë në Kosovë (UNFPA) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), filluan një iniciativë për promovimin e politikave miqësore ndaj familjes në vendet e punës. Kështu, u botua [analiza e politikave](#) mbi politikat kombëtare familjare të përgjegjshme gjinore me rekomandime për përmirësimin e

“Nga bashkëpunimi që ne kemi me RrGK-ë, kemi kuptuar sa e rëndësishme është që të mbështesim gratë në procese gjyqësore për të raportuar diskriminimin me bazë gjinore që iu bëhet në treg të punës. Rrjedhimisht, së bashku kemi mbështetur dhe monitoruar shumë rase.”

Arrita Rezniciq, Menaxhere e Programit
në Institutin e Kosovës për Drejtësi



kuadrit ligjor dhe harmonizimin e tij me Direktivën e BE-së për Balancimin Punë-Jetë. Përmes platformës së RrGK-së, 13 zyrtarë qeveritarë, akterë të sektorit privat, përfaqësues të shoqërisë civile zgjeruan të kuptuarit dhe njohuritë e tyre mbi politikat familjare të përgjegjshme gjinore dhe 61 persona janë njoftuar për politikat e përgjegjshme gjinore.

Institucionet dhe akterët kryesorë më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për ta adresuar atë

Vitin e kaluar, RrGK, së bashku me partnerët e saj rajonale, botuan shtatë raporte për diskriminimin me bazë gjinore dhe punën në rajon, duke përfshirë një raport për secilin nga gjashtë vendet e BP-së dhe një raport rajonal. Këto raporte përmbanin rekomandime specifike për institucionet për të adresuar më mirë diskriminimin me bazë gjinore dhe do të publikohen gjatë vitit 2022. Këtë vit, RrGK mbështeti katër organizata anëtare për të informuar palët e ndryshme të interesit në nivel lokal për përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore ndaj grave dhe për të promovuar



Organizata anëtare e RrGK-së “EULOC” organizoi vizitë në Viti në kuadër të iniciativës “Promovimi i Politikave Miqësore për Familjen”, nëntor 2021

politikat miqësore për familjen dhe vendet e punës, veçanërisht gjatë takimeve me përfaqësues të bizneseve.

Vetëdijesimi në mesin e palëve të interesit, duke përfshirë zyrtarët, OSHC-të dhe sindikatat lidhur me kornizën ligjore për diskriminimin përkatës dhe me mënyrat për përmirësimin e zbatimit të saj



Rrjeti, në bashkëpunim me partnerët e saj rajonalë, mbajti 84 takime për ngritjen e vetëdijesimit të palëve të interesit. Përfaqësuesit e këtij koalicioni, duke marrë pjesë në panele, seminare dhe konferenca të ndryshme kanë rritur vetëdijesimin e palëve të interesit për konceptet e diskriminimit dhe mënyrat për ta parandaluar atë. Koalicioni i lartpërmendur i koordinuar nga RrGK-ja ka nisur një fushatë në internet përmes të cilës i informon punëtorët për ngacmimet seksuale në punë dhe shkeljet e mundshme të të drejtave, përfshirë gjatë punës në kushte pandemie. Fushata gjithashtu i ofroi informacione njerëzve për ndihmën juridike falas nëse ata dëshirojnë të raportojnë ngacmimet seksuale, diskriminimin me bazë gjinore dhe shkeljet e të drejtave të grave punonjëse. Mediat në Kosovë kanë raportuar për nisjen e fushatës më shumë se gjashtë herë.

Po ashtu, RrGK mbajti shtatë takime me akterë relevantë dhe 63 takime me organizatat e shoqërisë civile për të planifikuar dhe ndërmarrë avokim të përbashkët drejt zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit. Kjo kontribuoi në 22 nisma të përbashkëta avokuese. Për më tepër, institucionet relevante kanë ndërmarrë hapa drejt adresimit të diskriminimit me bazë gjinore, si p.sh. përmes Task Forcës për Fuqizimin Ekonomik të Institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilën RrGK merr pjesë. Puna e RrGK-së për këtë çështje është mbuluar nga mediat 49 herë.

Disponueshmëria e informacionit, përfshirë hendekun gjinor të pagave, ekonominë joformale dhe skemat e sigurimit sociale është përmirësuar

RrGK nisi një iniciativë të re të financuar nga BE-ja mbi “Avancimin e Barazisë Gjinore përmes Anëtarësimit në BE”. Një nga aktivitetet do të përfshijë zhvillimin e analizave gjinore të sektorëve të paanalizuar për të informuar në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE. RrGK kishte planifikuar të bënte një analizë gjinore sektoriale për ekonominë joformale. Mënyra e vetme metodologjike për të studiuar këtë fenomen është nëpërmjet anketimeve nëpër shtëpi. Megjithatë, në mes të pandemisë COVID-19 dhe masave të izolimit, RrGK nuk mundi të realizonte anketimet sepse vlerësohej se një hulumtim kaq i gjerë do t'i rrezikonte qytetarët dhe hulumtuesit. Prandaj, duke marrë parasysh kufizimet në metodat e mundshme të hulumtimit në mes të COVID-19, bazuar në njohuritë e RrGK-së për analizat ekzistuese gjinore të disponueshme në sektorë të ndryshëm dhe pas konsultimeve me akterë të tjerë, RrGK ka identifikuar nevojën për të shtyrë hulumtimin në ekonominë joformale për vitin 2022, pasi të dhënat në këtë sektor mbeten të pakta.



Megjithatë, RrGK u takua me institucionet relevante, përfshirë BE-në dhe Inspektoratin e Punës për të diskutuar nevojën për të përmirësuar disponueshmërinë e të dhënave në lidhje me ekonominë joformale në veçanti.

Ndërkohë, Agjencia për Barazi Gjinore ka publikuar edhe një raport për hendekun gjinor të pagave në Kosovë, jashtë sferës së punës së RrGK-së, por që do të kontribuojë në përmirësimin e qasjes në informata për këtë çështje.

Qasja në drejtësi në rastet e diskriminimit gjinor në punë është përmirësuar

Së bashku me partnerët në rajon, RrGK e lehtësoi qasjen e grave në drejtësi duke iu ofruar atyre ndihmë juridike, përfshirë gjatë pandemisë COVID-19. Ky koalicion i udhëhequr nga RrGK vazhdoi të ofrojë përfaqësim ligjor dhe monitorim të rasteve të diskriminimit me bazë gjinore në drejtim të përmirësimit të trajtimit të këtyre rasteve në vitin 2021. Në nivel rajonal, janë mbështetur katër raste strategjike gjyqësore që kanë të bëjnë me diskriminimin me bazë gjinore ndaj grave në punë.

“Me ndihmën e Komitetit të Helsinkit, punëdhënësi më pagoi pagën e plotë për muajt kur më duhej të qëndroja në shtëpi dhe të kujdesesha për fëmijën tim.”

Grua e cila mori ndihmë juridike nga Komiteti i Helsinkin në Maqedoninë e Veriut



Më shumë mundësi të përballueshme për përkuqdesje të fëmijës janë në dispozicion

Në kontributin e lartpërmendur të RrGK-së në tre dokumente të politikave, veçanërisht lidhur me anëtarësimin në BE (Raporti i Kosovës, Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023, dhe Agjenda e Reformës Evropiane II), si dhe në lidhje me një takim të nënkomitetit të Marrëveshjes së Stabilizim – Asocimit dhe në një takim me Ministrinë i Arsimit, Teknologjisë Shkencës dhe Inovacionit, RrGK theksoi vazhdimisht rëndësinë që Kosova të ofrojë më shumë mundësi të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve në mënyrë që t'u mundësojë më shumë grave të kyqen në tregun e punës.

RrGK-ja ka vazhduar të avokojë te qeveria që të hap më shumë qendra të kujdesit për fëmijët, si dhe te financuesit ndërkombëtarë që të mbështesin këtë gjë. Në mes të epidemisë së COVID-19, mungesa e disponueshmërisë së kujdesit për fëmijët u vërejt gjithashtu si një çështje serioze për gratë, disa prej të cilave humbën punën e tyre sepse nuk kishin asnjë mundësi përkuqdesjeje në dispozicion mes masave të izolimit.

Si rezultat i avokimit të RrGK-së, kjo çështje është përfshirë në Programin e Reformës Ekonomike 2021-2023 dhe në Agjendën e Reformës Evropiane II. Madje, MESTI u pajtua ta adresojë atë.

Rritet përqindja e grave që kanë qasje në trashëgimi dhe pronë

RrGK nuk kontribuoi drejtpërdrejt në rritjen e përqindjes së grave që kanë qasje në trashëgimi ose pronë këtë vit. Megjithatë, anëtarët e RrGK-së vazhduan të punojnë në këtë fushë.



Më shumë qytetarë të vetëdijesuar lidhur me të drejtat e grave për trashëgimi dhe pronësi

RrGK ka punuar më pak për këtë në vitin 2021, duke pasur parasysh se RrGK së bashku me anëtarët e saj tashmë e ka tejkaluar objektivin e saj, duke arritur 10,007 gra dhe burra të ndryshëm për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me të drejtat e grave në trashëgimi dhe të drejtat pronësore.

Përmirësimi i perspektivës gjinore në reformat që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE

Siç ilustron nga rezultati vijues dhe rezultatet e lartcekura, komentet e RrGK-së për dokumentet që lidhen me anëtarësimin në BE kanë kontribuar në përmirësimin e perspektivës gjinore në reformat që lidhen me BE-në. Disa nga rekomandimet e RrGK-së janë marrë nga qeveria dhe/ose BE, duke përmirësuar kështu perspektivën gjinore në reforma. Për shembull, në vitin 2021, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i referohej gjinisë 98 herë në mënyra të ndryshme, një rritje krahasuar me 72 herë në vitin 2020. Për Barazinë gjinore diskutohet në 17 sektorë të ndryshëm.

Monitorimi i politikave dhe programeve të BE-së në Kosovë nga perspektiva gjinore është përmirësuar

RrGK ka vazhduar të rishikojë veprimet dhe kontratat e mbështetura nga BE-ja në Kosovë, në drejtim të integritetit të një perspektive gjinore brenda këtyre dokumenteve. Në vitin 2020, RrGK zhvilloi një rishikim të shpejtë të programeve të BE-së në zhvillim e sipër për të identifikuar fushat ku kontraktorët



mund të integrojnë më mirë perspektivën gjinore në punën e tyre dhe RrGK do të vazhdojë me këto rekomandime me BE-në, kontraktorët dhe përfituesit, përfshirë qeverinë e Kosovës në vitin 2021. Këtë vit, RrGK ka mbështetur monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor të BE-së (GAP) II në Kosovë dhe në rajonin e BP-së duke marrë pjesë në një vlerësim të zbatimit të tij, duke mbështetur BE-në në Kosovë në monitorimin e zbatimit të tij dhe shkruarjen e përmbledhjeve të politikave në lidhje me këtë temë, [Realizimi i Angazhimeve të BE-së: Rekomandimet për Integrimin Gjinor në IPA III](#).



Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor

Përmirësimi i qasjes në edukimin cilësor dhe të ndjeshëm gjinor është program i ri në Strategjinë e RrGK, pasi kjo u vendos nga anëtarët e RrGK-së. Për herë të parë, RrGK siguroi fonde për arritjen e këtij objektivi afatgjatë. Për më tepër, RrGK ka vazhduar të mbështesë anëtarët e saj përmes FGK-së. Nismat e tyre janë duke u zbatuar. Ndërkohë, si rezultat i përpjekjeve të përmendura të RrGK-së, zyrtarët qeveritar janë zotuar të përmirësojnë qasjen në qendra të fëmijëve në dy dokumente kyçe të politikave dhe kjo mund të kontribuojë në përmirësimin e qasjes së vajzave (dhe djemve) në edukimin e hershëm.

Rritja e numrit të qendrave të kujdesit për fëmijë në proporcion me numrin e fëmijëve në nevojë

Siç shihet në pjesët e mëparshme, krijimi i më shumë qendrave të kujdesit ndaj fëmijëve dhe institucioneve parashkollore mund të krijojë vende pune, të kontribuojë në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore dhe të përmirësojë rezultatet arsimore për fëmijët përmes kualifikimit më të mirë për punë të mëvonshme. Siç u përmend, RrGK ndërmorri katër nisma avokuese për më shumë qendra parashkollore dhe të përkujdesit për fëmijë.

Përveç këtyre përpjekjeve të cekura më lart, gjatë vitit të ardhshëm, RrGK në bashkëpunim me anëtarët e saj, do të avokojë për inspektime më të mira të institucioneve parashkollore dhe qendrave të



kujdesit për fëmijë në lidhje me cilësinë e arsimit të ofruar në përputhje me legjislacionin e arsimit parashkollor.

Përmirësimi i kurrikulës dhe teksteve shkollore nga perspektiva gjinore

RrGK filloi bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për arritjen e këtij objekti. Më 23 korrik, RrGK organizoi takimin e parë me zëvendësministre Edona Maloku-Bërdyna, dhe asistente administrative të zëvendësministres Gerta Ymeri. Gjatë takimit RrGK prezantoi idenë e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve mbi parandalimin e përforcimit të stereotipeve gjinore dhe roleve tradicionale gjinore përmes edukimit.

Për më tepër, RrGK ngrii shqetësimin për mungesën e informacionit dhe edukimit seksual te të rinjtë në vend në kurrikulat që mësohen në shkolla. RrGK dhe MASHTI nënshkruan një Memorandum të Bashkëpunimit për bashkëpunimet e tyre në të ardhmen.



Vlerësimi i punës së RrGK-së

RrGK monitoron dhe vlerëson punën e vet në disa mënyra. RrGK ka zhvilluar një Databazë të Monitorimit dhe Vlerësimit me qëllim që të përcjellë progresin në indikatorët e rezultateve të menjëhershme (*output*), objektivat dhe nivelin e ndikimit me kalimin e kohës, bazuar në Strategjinë organizative të RrGK-së. Staf i përditëson rregullisht databazën me të dhëna lidhur me indikatorët, gjë që mundëson raportimet semestrale tek anëtarët dhe këtë raportim vjetor. Gjatë Kuvendit Vjetor të RrGK-së, anëtarët në mënyrë anonime e vlerësuan shumë pozitivisht punën e RrGK. Më poshtë janë disa nga komentet e tyre: *Shërbimet e RrGK ndaj neve janë shumë të dobishme- “Një dritë në fund të tunelit, diell për të gjithë, suksese suksese pa ndërprerë, ju lumt”!*

“Përmes Rrjetit të Grave të Kosovës shihet fuqizimi i grave në vendimarrje si dhe bashkëpunimi në mes grave”

“Me ndihmën e stafit profesional të RrGK kemi marrë trajnim të duhur për ngritjen e kapaciteteve tona”

“Rrjeti i Grave kontribon për gratë në përgjithësi si dhe për mbrojtjen e viktimave”



Stafi i RrGK-së “është në dispozicion 24 orë, 7 ditë në javë. Jeni të pazëvendësueshme!”

“RrGK është profesionale dhe e nevojshme për organizatat në Kosovë”

“Aktiviteti dhe angazhimi i tyre, afërsia e stafit me gratë jep të kuptohet se nuk ka fjalë që mund ti përshkruash”

Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2021

Donatori dhe numri i kontratës	Projektet	Fondet e bartura nga viti 2020	Fondet e pranuar gjatë vitit 2021	Gjithsej fonde 31.12.2021	Gjithsej shpenzim e 31.12.2021	Bilanci (do bartet në vitin 2022)
"Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Bashkëpunim 8299-01/2018 (01.01.2018-28.02.2021)"	Avancimi i mëtejme i të drejtave të grave në Kosovë	2,386.83	50,000.00	52,386.83	52,386.83	-

Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) 8299-00/2021, dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) 14853 (01.03.2021-28.02.2025)	Avancimi i mëtejshëm i të drejtave të grave në Kosovë II		579,808.78	579,808.78	76,895.27	502,913.51
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar	Fuqizimi i OshC-ve në Luftimin e Diskriminimit dhe Avancimin e të drejtave të	112,813.89	231,150.28	343,964.17	251,106.00	92,858.17

r (Sida) 2018/394402 (23.03.2018- 28.02.2022)	grave në punë					
Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë 2018/404-465 (20.12.2018- 20.12.2022)	Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë	55,143.9 5	135,626.75	190,770.70	103,246. 20	87,524.50
Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë 2019/414-028 (01.03.2020- 30.04.2023)	Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të Anëtarësimit në BE	3,024.56	57,835.72	60,860.28	37,446.1 3	23,414.15



Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë 2021/426-885 (01.09.2021-30.06.2023)	Rritja e Kapaciteteve dhe Qëndrueshmërisë së OshC-ve për përparimin e Barazisë Gjinore në mes të Pandemisë COVID-19		362,128.00	362,128.00	10,244.23	351,883.77
Zyra e Bashkmit Evropian në Kosovë 2020/415-391 (13.03.2020-12-11.2022)	Përkrahje në zbatimin e GAP II dhe integrimin e perspektivës gjinore	15,835.50	17,494.00	33,329.50	27,202.28	6,127.22

Fondacioni Kvinna till Kvinna KO01SID34- 31009 and KO01RAM03- 31009 (01.01.2021- 31.12.2023)	Mbështetje Institucionale	9,955.48	84,143.82	94,099.30	88,470.6 4	5,628.66
Fondacioni Kvinna till Kvinna BN55SID16 - 2019 (01.04.2019- 31.12.2021)	Financimi i Lëvizjes së Grave në Ballkanin Perëndimor	3,217.70	2,588.18	5,805.88	3,594.77	2,211.11

Un Women 2019 PCA - 00113666 (05.11.2019- 31.01.2021)	Fuqizimi i Rinisë për një të Ardhme Paqësore, të Begatë dhe të Qëndrueshm e në Kosovë	2,328.69		2,328.69	2,328.69	-
Un Women 2020 PCA - 00113666 (19.05.2020- 21.04.2021)	Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve - EVAW II	15,207.3 7	4,818.70	20,026.07	18,902.2 7	
"ADA dhe Sida përmes Qendrës për Hulumtime dhe Politikëbërje, 2841-00/2019	Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinor në BP dhe në Republikën e Moldavisë	5,069.48	28,435.45	33,504.93	23,898.0 9	9,606.84

(01.11.2019-31.07.2022)"						
ADA përmes Qendrës Autonome të Grave / ADA-GBV 8374-02/2019 (01.12.2019-31.12.2022)	Institucionalizimi i Rehabilitimit Cilësor dhe Shërbimeve të Integritit për të Mbijetuarat e Dhunës	29,116.27	71,064.65	100,180.92	64,868.14	35,312.78

Fondi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) (01.05.2021- 30.11.2022)	Zbatimi i planit të punës të financuar nga UNFPA në lidhje me Planin e Përbashkët të Zhvillimit 2021-2025 të Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (RKSKB 1244)		31,346.80	31,346.80	8,870.02	22,476.78
--	---	--	-----------	-----------	----------	-----------

UN Women EVAW 00119636 (01.09.2021- 01.03.2023)	Përmirësimi i kapaciteteve organizative të strehimoreve në trajtimin e dhunës seksuale duke përfshirë gratë nga minoritetet		19,986.25	19,986.25	16,593.4 4	3,392.81
Fondi Sigrid Rausing Trust (01.06.2021- 31.05.2022)	Mbështetje Institucionale		116,125.62	116,125.62	13,079.9 5	103,045.67
Caritas (01.11.2020- 30.11.2021)	Zhvillimi ekonomik rural i qëndrueshëm dhe	1,525.20	15,000.00	16,525.20	10,715.9 5	


	gjithëpërfshirës (SIREDA)					
Fondi i Kombeve të bashkuara për Zhvillim (UNDP)	Konsulecë dhe hulumtim		4,831.17	4,831.17	4,831.17	
FAO	Vlerësimi i avancimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik të grave në bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë		5,000.00	5,000.00	63.75	4,936.25

Fondacioni Zemra dhe Dora	Mbështetje e përgjithshme	1,053.68	1,242.30	2,295.98	-	2,295.98
Altrusa	Fondi i qëndrueshmërisë	881.48		881.48	-	881.48
KFOR donacionet vullnetare	Fondi i qëndrueshmërisë		3,689.50	3,689.50	-	
Donacionet e per RrGK	Fondi i qëndrueshmërisë	11,857.32	6,009.74	17,867.06	5,132.69	12,734.37
Total		269,417.40	1,828,325.71	2,097,743.11	819,876.51	1,267,244.05

Shpërndarja e shpenzimeve për vitin 2021

Gjithsej shpenzime për vitin 2021	819,876.51	100.00%
Kostot administrative	112,012.40	13.66%
Kostot operacionale	17,381.57	2.12%
Kostot programatike	434,963.22	53.05%
Grantet	255,519.32	31.17%

SHPËRNDARJA E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2021



Rrjeti i Grave të Kosovës

Për Menaxhmentin e Rrjeti i Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë

Prill 2022

Të nderuar,

Letër Menaxhmenti për vitin e mbaruar Dhjetor 31, 2021

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të Rrjeti i Grave të Kosovës për vitin e mbaruar Dhjetor 31, 2021, kemi konsideruar strukturën e brendshme në mënyrë që të vendosim për procedurën e auditimit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara, por jo për të ofruar siguri në kontrollin e brendshëm.

Në kemi kontrolluar në bazë të mostrimit, prova që mbështesin shumat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Për më tepër, kemi vlerësuar parimet e kontabilitetit të përdorura nga menaxhmenti.

Qëllimi i kësaj letre të menaxhmentit është që ti prezentoj një sërë rekomandimesh menaxhmentit të RrGK duke u bazuar në gjetjet e auditorit përgjatë rrjedhës së auditimit. Synimi i letrës së menaxhmentit nuk është të kritikojë ose dënojë aktivitetet të cilat janë vërejtur. Mirëpo, synimi është që të propozojë përmirësime në fushatë ku auditori mendon se duhet të ketë ndonjë të tillë.

Çështjet e ngritura në këtë letër janë vetëm ato që kanë kapur vëmendjen tonë gjatë rrjedhës së auditimit dhe jo domosdoshmërisht deklarata të plota e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Do të ishte kënaqsi të diskutojmë për çështjet e ngritura gjatë auditimit dhe të asistojmë menaxhmentin për të implementuar ato nëse është e nevojshme.

Poashtu duam që të shprehim falenderimin tonë për bashkëpunimin e menaxhmentit dhe punonjësve të RrGK gjatë punës sonë.

Në rast se keni ndonjë pyetje mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

ACA - Audit & Consulting Associates
Prishtina, Kosovë



Rreth nesh

Bordi i Drejtorëve të RrGK-së

Ariana Qosaj Mustafa, Kryesuese e Bordit

Magbule Hyseni, Drejtore Ekzekutive, EcoKosWomen (*EKW*)

